

Bashkia Durrës

Plani i Zhvillimit të
Komunitetit Rom dhe Egjiptian

2017-2020



BASHKIMI EVROPIAN



BASHKIA DURRËS



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E SHëndETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE



Institute for Democracy and Mediation
Institut për Demokracinë dhe Mediimin



Empowered lives.
Resilient nations.



Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit 2017-2020

Draft Plani

Përgatitja e Planit të Zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit (2017-2020) u mundësua në kuadër të Projektit “Fuqizimi Ekonomik dhe Social i Romëve dhe Egjiptianëve – një shtysë për përfshirje sociale” (FESRE), financuar nga BE dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) në Shqipëri. Procesi planifikues u asistua nga ekspertët e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në bashkëpunim me Grupin Lokal me Pjesëmarrje të krijuar në Bashkinë e Durrësit përgjatë muajve Dhjetor 2016-Shtator 2017.

Grupi i ekspertëve të IDM-së:

Armela Xhaho

Evelina Azizaj

Shefqet Bruka

Ekspertët Lokal

Aurora Koçi

Elson Korra

Kryetar i Grupit Lokal të Planit të Zhvillimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

Meme Xhaferaj, Drejtore e Shërbimit Social, Bashkia Durrës

Publikimi i këtij materiali u mundësua me mbështetjen financiare të projektit “Fuqizim Ekonomik dhe Social për Romët dhe Egjiptianët – shtysë për përfshirjen sociale”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Pikëpamjet e shprehura në këtë material nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pozicionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose agjensive të saj.

Grupi lokal me pjesëmarrje për hartimin e planit të zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian

Emër/Mbiemër	Institucioni	Pozicioni i punës	Email
Meme Xhaferaj	Bashkia Durrës	Drejtoreshë e Shërbimeve Sociale	mxhaferaj@yahoo.com
Diana Mandija	Bashkia Durrës	Drejtoreshë e Shërbimeve	diana_mandija@yahoo.com
Emiriana Sako	Bashkia Durrës	Drejtoreshë e Shërbimeve Publike	emirianasako@gmail.com
Mimoza Reka	Bashkia Durrës	Shefe Sektori, Ndhimja Ekonomike dhe Përkrahja sociale	reka_moza@yahoo.com
Nadire Jani	Këshilli Bashkiak Durres	Anëtare Këshilli Bashkiak	diri1960@hotmail.com
Shaban Lufta	Bashkia Durrës	Moderator	shabanlufta@hotmail.com
Zerina Bello	Bashkia Durrës	Adm. Shoqerore	era_bello@hotmail.com
Olta Dedej	Bashkia Durrës	Specialiste, NJMF	oltabajraktari@yahoo.com
Stela Prifti	Drejt. Raj. Shendet.	Mjeke	stelaprifti@yahoo.com
Fatbardha Emiri	DRSH spec.	Mjeke familje	fmancaku@yahoo.com
Evelina Balliu	DRSH		evelinaballiu@yahoo.com
Entela Hamiti	DRFSDKSH	Mjeke	ehamiti@yahoo.com
Majlinda Ciraku	Prefektura	Sp. Sherbimesh	mciraku@yahoo.com
Adelina Kurti	Nj. Adm. Sukth	NjMF	kurtiadelina@yahoo.com
Liljana Cani	DAR	Specialiste Kurrikulës dhe Cilësisë	lijjanacani@yahoo.com
Dorina Binjaku	DAR	Psikologe shkollore	dorinabinjaku@gmail.com
Ornela Hamataj	Qend. Komun. Nishtulla	Drejtoreshë	ornelahamataj@hotmail.com
Majlinda Mema	Zyra Rajonale e Punësimit	Shefe Sektori	mema_majlinda@yahoo.com
Adelina Hoxha	Zyra e Punes	Specialiste	adelinahoxha80@gmail.com
Alketa Myftari	Zyra e Punes	Sp. Sherbimesh	alketa.bendo@yahoo.com
Marilda Gushmari	ZRP Durres	Sp. Punesimi	mail.marilda@yahoo.com
Irena Mulla	QFP Durres	Specialiste	mullairena@gmail.com
Aurora Koci	IDM Albania	Eksperte lokale	aurorakoci.irca@gmail.com
Elson Korra	IDM Albania	Ekspert lokal	elsonkorra@hotmail.com
Altin Xhaferri	IRCA	Aktivist	altinxhaferri2@hotmail.com
Elisabeta Qati	Nj. Adm. Rrashbull	NjMF	e.qati2015@gmail.com
Migena Muhaj	World Vision	Lider Grupi Durres AP	migena_muhaj@wvi.org
Ismail Jakupi	USHTEN	Koordinator	ili.jakupi@gmail.com
Guliem Korra	Komuniteti	Aktivist	guliem_korra@hotmail.com

Tabela e përmbajtjes

SHKURTIME	8
HYRJE	13
KAPITULLI I. QASJA METODOLOGJIKE	19
Parimet udhëzuese të planit të zhvillimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	20
Metodologjia	24
Aktorët e përfshirë	26
KAPITULLI II. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE	29
Romët dhe egjiptianët në Bashkinë e Durrësit	30
1. Regjistrimi civil dhe aksesimi në sistemin e drejtësisë	33
2. Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor	35

3. Punësimi dhe arsimit dhe formimi profesional (afp)	48
4. Kujdesi shëndetësor	55
5. Strehimi dhe integrimi urban	63
6. Mbrojtja sociale	73

KAPITULLI III. PLANI I VEPRIMIT	79
--	-----------

3.1 Deklarata e vizionit	80
3.2 Qëllimi strategjik	81
3.3 Matrica	82

KAPITULLI IV. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT	111
--	------------

ANEKSE	117
---------------	------------

Shkurtime

AFP	Arsimi e Formimi Profesional
CRCA	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale, Durrës
DL	Drejtoria Ligjore
DTTV	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore
DSHS	Drejtoria e Shërbimit Social
DPZH	Drejtoria e Politikave të Zhvillimit
DSH	Drejtoria e Shërbimeve
DAKRSKF	Drejtoria e Arsim-Kulturë-Rini-Sport, Komuniteteve Fetare
FSDKSH	Fondi i Sigurimeve të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, dega Durrës
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KB	Këshilli i Bashkisë, Bashkia Durrës
KE	Komisioni Evropian
NjA	Njësi Administrative
NjEF	Njësive Ekonomike Familjare
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, Bashkia Durrës

OCR	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve
OSFA	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
PBShSh	Paketa Bazë e Shërbimeve shëndetsore
PB	Policia Bashkiake
QKEV	Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim
QSH	Qendra Shëndetësore
QEA	Qendra Ekonomike Arsimit
SKTTV	Spektori Kontrollit të taksave dhe tarifave vendore
SKRSKF	Spektori i kulturës, rinisë, sporteve dhe komun.fetare
SNIN	Spektori Ndjekjeve të Investimeve dhe Ndërmarrjet
SNEI	Spektori i Ndhmës Ekonomike dhe Invaliditetit
SSHS	Spektori Shërbimeve Sociale
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Zyra Durrës
SHQK	Shkolla Qendër Komunitare
TLAS	Shërbimi Ligjor Falas
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

Falënderime

Hartimi i Planit të zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Durrës është fryt i punës së përbashkët të institucioneve publike dhe jo-publike në nivel vendor dhe rajonal të lidhura drejtëpërdrejtë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komunitetit Rom dhe Egjiptian duke përfshirë: Bashkinë Durrës, Zyrën Rajonale të Punësimit, Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë, Drejtorinë Rajonale Arsimore, Zyrën Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Organizatat e Shoqërisë Civile, organizatat rome dhe egjiptiane.

Ky plan është një instrument demokratik planifikimi dhe menaxhimi, i cili synon të adresojë sfidat dhe barrierat të cilat pengojnë dy komunitetet në sigurimin e një jete dinjitoze. Ai paraqet qëllimet strategjike, objektivat specifik për fusha të caktuara dhe hapat e veprimit konkret të aktorëve vendorë. Respektimi i të drejtave të komunitetit Rom dhe Egjiptian kërkon që vizioni dhe misioni ynë, vlerat dhe modeli gjithëpërfshirës të jenë pjesë e rrugëtimit të përbashkët të shumë bashkëpunëtorëve, me qëllim për të arritur rezultate pozitive.

Falënderojmë anëtarët e grupit të punës, të cilët në aktivitetet periodike të organizuara gjatë procesit të hartimit, me mendimet, sugjerimet dhe diskutimet e tyre kanë dhënë një kontribut tepër të vyer në hartimin e këtij dokumenti.

Mirënjohje e thellë i drejtohet Organizatës Ndërkombëtare PNUD, për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë Bashkisë Durrës në integrimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian, ekspertëve të Institutit për Demokraci e Ndërmjetësim për asistencën teknike përgjatë hartimit të këtij dokumenti.

Falënderim të veçantë për të gjithë aktivistët dhe banorët e dy komuniteteve si dhe organizatat e shoqërisë civile, e sidomos ato të komunitetit Rom dhe Egjiptian dhe çdo aktor tjetër që ka qënë pjesë e hartimit të këtij plani.

Një falënderim i veçantë i shkon Bashkimit Evropian, i cili nëpërmjet mbështetjes financiare në kuadër të projektit ESERE bëri të mundur hartimin dhe botimin e këtij dokumenti strategjik.

KRYETARI

Vangjush Dako





HYRJE



Plani për Zhvillimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian është një instrument demokratik planifikimi dhe menaxhimi që synon të adresojë në terma afatshkurtra sfidat me të cilat përballen të dy komunitetet duke synuar arritjen e një vizioni që lidhet me një shkallë më të lartë integrimi të anëtarëve të të dy komuniteteve në jetën sociale dhe ekonomike në nivel lokal.

Ky plan shërben si një mekanizëm orientues i veprimeve që aktorët vendorë dhe rajonalë duhet të ndërmarrin për të adresuar sfidat dhe barrierat që pengojnë dy komunitetet në sigurimin e një jete dinjitoze. Dokumenti i planit fillimisht jep një pasqyrë të situatës aktuale të komunitetit Rom dhe Egjiptian lidhur me gjashtë sfidat kryesore (ku jemi aktualisht në lidhje me: a) regjistrimin civil dhe aksesin në drejtësi; b) arsimimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor; c) kujdesin shëndetësor; d) punësimin, formimin dhe edukimin profesional; e) strehimin dhe integrimin urban, si dhe f) mbrojtjen sociale).

Pas analizës së situatës aktuale, plani propozon vizionin për zhvillimin e dy komuniteteve (se si duam ta shohim komunitetin Rom dhe Egjiptian pas 7-10 vitesh) dhe cili është itinerari për të arritur aty ku dëshirojmë në të ardhmen, ose me fjalë të tjera, plani i veprimit që adreson sfidat sipas gjashtë fushave prioritare. Plani i veprimit paraqet qëllimet strategjike dhe objektivat specike për gjashtë fushat, ndërsa çdo objektiv ka të renditura projektet dhe hapat e veprimit konkret, të cilat janë të detajuara në lidhje me ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet aktorëve lokalë dhe rajonalë, implikimet financiare, burimet e të ardhurave, si dhe treguesit e performancës dhe afatet kohore. Zbatimi i hapave të veprimit në përputhje me afatet kohore dhe treguesit e synuar duhet të monitorohet dhe të raportohet.

PZHK është një instrument praktik dhe relativisht i thjeshtë për t'u përdorur jo vetëm nga aktorët publikë (administrata lokale e bashkisë dhe e institucioneve të tjera vendore të dekoncentruara si Drejtoria Arsimore

Rajonale, Fondi Shëndetësor, Insituti i Shendetit Publik, policia, etj), por edhe nga aktorët e shoqërisë civile, grupet e ndryshme sociale, në kontributin e tyre për adresimin e sfidave sipas veprimeve të parashikuara në Plan, duke bërë të realizueshëm edhe vizionin e artikuluar në dokument. Koordinimi i përpjekjeve ndërmjet aktorëve lokalë për zbatimin e këtij plani është tejet i rëndësishëm duke marrë në konsideratë faktin që një dokument i tillë reflekton nevojat dhe preferencat e anëtarëve të dy komuniteteve dhe të aktorëve të tjerë lokalë. Procesi planifikues ka siguruar hapësirë që anëtarët e dy komuniteteve të kenë një zë në vendimet që ndikojnë zhvillimin e tyre dhe se ndërhyrjet për zhvillim janë të përshtatshme me nevojat dhe preferencat e tyre. Procesi i hartimit të planit ka patur natyrë të lartë pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse dhe dokumenti final është rezultat i konsultimeve të gjera me aktorë publikë dhe jopublikë që veprojnë në sektorë të ndryshëm.

Pikërisht identifikimi i (dis)avantazheve të vazhdueshme me të cilat përballen këto komunitete dhe orientimi i politikave vendore në funksion të përfshirjes dhe zhvillimit socio-ekonomik të komuniteteve vulnerabël kërkon një ndërhyrje efektive multisektoriale dhe shumë-aktoriale në nivel vendor. Plani strategjik nuk është vetëm një parakusht për të mobilizuar burime të tjera financimi dhe akses në fonde nga donatorë të ndryshëm, por edhe një tregues tepër i rëndësishëm në përpjekjen për të rritur mirëqenien, integrimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për këto grupe në nevojë. E thënë ndryshe, politikat në nivel vendor të orientuara drejt përfshirjes sociale kanë një efekt pozitiv jo vetëm në adresimin e nevojave dhe sfidave me të cilat përballen këto komunitete, por edhe më tej në integrimin e qëndrueshëm në fushat prioritare, si: punësimi, arsimimi, strehimi, mbrojtja sociale, shëndetësia.

Plani i zhvillimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Durrësit fokusohet në trajtimin e gjashtë sfidave të identifikuara edhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-

2020, por të lidhura më ngushtë me kontekstin vendor. Ky plan zhvillimi është hartuar me synimin që të shërbejë si instrument për orientimin e përpjekjeve ndërsektoriale dhe shumaktorëshe në lidhje me integrimin social-ekonomik të dy komuniteteve në bashkinë e Durrësit. Njohja e mirë e potencialeve dhe sfidave me të cilat përballen dy komunitetet në 6 fushat prioritare: rregjistrimi civil dhe aksesimi në drejtësi, arsimimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor, kujdesi shëndetësor, punësimi dhe formimi profesional, strehimi dhe integrimi urban si dhe mbrojtja sociale, arrin të mbulojë dhe adresojë gamën e gjerë të probematikave shumedimensionale të të dy komuniteteve.

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesorë. Në kapitullin e parë përshkruhet qasja metodologjike e procesit planifikues të këtij dokumenti, parimet e planit, modeli konceptual i procesit planifikues sipas fazave, instrumentet e përdorura, duke vënë theksin edhe te aktorët e përfshirë në këtë proces. Në kapitullin e dytë paraqitet situata aktuale e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Durrësit sipas gjashtë fushave prioritare të përmendura më sipër. Kapitulli i tretë paraqet deklaratën e Vizionit dhe qëllimet strategjike të planit, i cili vijon me kapitullin e matricës së planit të veprimit, që përfshin qëllimet strategjike, objektivat specifike dhe aktivitetet sipas fushave prioritare. Në kapitullin e fundit, rëndësi të veçantë i kushtohet monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të planit, pasi është tejet e nevojshme dhe e rëndësishme ndjekja e zbatimit të strategjisë për të vlerësuar rezultatet e pritura të objektivave strategjike.

Qëllimi kryesor i procesit planifikues është t'u jap grupeve vulnerabël si rom dhe egjiptian një mjet që fuqizon në mënyrë të veçantë grupet në nevojë, duke i bërë ato pjesëmarrëse direkte në vendimmarrje, nëpërmjet dizenjimit të aktivitete konkrete të planit të veprimit për zhvillim nga vetë ata. Kjo bëhet më domethënëse kur planifikimi i zhvillimit synon specifikisht grupet në nevojë, si komunitetet Rome dhe Egjiptiane, të cilët jetojnë në kushte të vështira socio-ekonomike dhe janë të përjashtuar nga proceset vendimmarrëse që ndikojnë jetët e tyre, por konkretisht edhe nga një sërë shërbimesh publike.

Shkëputur nga Guida (IDM 2017)



KAPITULLI 1

QASJA METODOLOGJIKE



Parimet udhëzuese të planit të zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian

Në thelb të të gjitha nismave në nivel lokal që synojnë integrimin e anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian duhet të mbeten të gjitha parimet e mëposhtme, duke vënë theksin në qasjen ndërsektoriale dhe shumëaktorëshe që kërkohet prej tyre. Si pasojë e nevojës së kësaj qasjeje, ajo çfarë është emergjente dhe kërkohet nga realiteti i aktorëve vendorë në Shqipëri është forcimi i koordinimit mes institucioneve në nivel lokal si dhe partneriteti ndërmjet sektorit publik dhe jopublik.

1. Nxitja e përfshirjes sociale

Plani i Zhvillimit të Komunitetit i kushton një vëmendje të veçantë nxitjes së përfshirjes sociale të komunitetit Rom dhe Egjiptian. Përpos masave të qeverisë shqiptare për integrimin e këtij komuniteti në shoqëri, në përgjithësi ekziston një frymë përjashtuese dhe marginalizuese duke i bërë këto grupe vulnerabël. Plani orientohet veçanërisht në përpjekjet për të rritur aksesin e romëve dhe egjiptianëve në punësimin formal, në të gjitha nivelet e sistemit arsimor si dhe në programet e mbrojtjes sociale, në kujdesin shëndetësor, në aksesin në drejtësi dhe strehim me qëllim rritjen e mirëqënies së këtij komuniteti dhe integrimin në jetën sociale dhe ekonomike në komunitetet lokale. Plani promovon parimin e përfshirjes sociale duke i përfshirë vetë anëtarët e grupeve vulnerabël në procesin e planifikimit strategjik.

2. Respektimi i dallimeve

Plani i Zhvillimit të Komunitetit respekton dallimet që ekzistojnë ndërmjet komunitetit Rom dhe atij Egjiptian në fushat e ndryshme prioritare. Po ashtu, plani bën dallim edhe midis diferencave që ekzistojnë brenda vetë nëngrupeve të këtyre komuniteteve, duke mos homogjenizuar grupin/komunitetin si një të tërë. Popullata rome në Shqipëri është e përbërë nga

disa nëngrupe / subkultura të cilët dallohen nga njëra-tjetra përgjithësisht nga dialekti, periudha kur kanë mbërritur në Shqipëri si dhe trajektorja e rrugëtimit. Megjithatë, integrimi i dy komuniteteve vazhdon të jetë ende një sfidë në vazhdimësi, e megjithatë plani njeh faktin se disa nëngrupe janë tashmë më të integruara në shoqëri.

3. Qasja ndërsektoriale

Plani i Zhvillimit të Komunitetit vë theksin në nevojën e një qasjeje ndërsektoriale dhe shumë aktorëshe në mënyrë që përpjekjet për integrimin e dy komuniteteve të sjellin rezultate konkrete. Integrimi në jetën sociale dhe ekonomike të romëve dhe egjiptianëve është i mundur nëse adresohen barrierat e përfshirjes sociale në mënyrë të integruar, pra njëkohësisht në shumë prej sektorëve si: arsimimi, shëndetësia, strehimi dhe integrimi urban, punësimi, arsimit dhe aftësimi profesional, mbrojtja sociale, regjistrimi civil si dhe aksesit në sistemin e drejtësisë, duke promovuar zhvillimin dhe integrimin në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme përmes ndërhyrjeve ndërsektoriale.

Zbatimi i planit thekson rëndësinë që merr koordinimi i aktorëve lokalë publik dhe jo-publik.

4. Dimensoni i integritit gjinor:

Plani i Zhvillimit të Komunitetit nënvizon rëndësinë e integritit të dimensionit gjinor në të gjitha hapat dhe proceset e ndërmarra në këtë kuadër. Integrimi gjinor në terma konkrete përkthehet në të dhënat e disagreguara sipas gjinisë dhe në po të njëjtën kohë hartimin e objektivave duke patur parasysh pasojat e tyre për të dyja gjinitë. Për më tepër, plani pranon faktin se gratë rome dhe egjiptiane kanë më shumë gjasa të ndihen të diskriminuara dhe përjashtuara. Kjo, së pari, për shkak të racës dhe së dyti për shkak të gjinisë. Gratë në përgjithësi kanë një qasje më të kufizuar ndaj burimeve ekonomike dhe të vendimmarrjes, shpesh për

shkak të mentalitetit dhe praktikave tradicionale të cilat kontribuojnë në pabarazitë dhe përjashtimin e tyre të vazhdueshëm nga jeta sociale dhe shoqërore. Veprimet e planit kanë një ndjeshmëri gjinore dhe promovojnë arritjen e parimit të barazisë gjinore. Ulja e hendekut të pabarazive midis grave dhe burrave është një element tepër i rëndësishëm i qeverisjes së mirë dhe pritshmërive që BE parashtron ndaj çdo vendi kandidat në lidhje me integrimin gjinor.

5. Parimi i pjesëmarrjes aktive:

Angazhimi konstruktiv i aktorëve lokalë dhe vetë komunitetit Rom dhe Egjiptian në të gjitha hapat e PZHK-së siguron një model të qëndrueshëm të vendimmarrjes pjesëmarrëse dhe efektive. Proçesi i hartimit të planit është në funksion të gjithëpërfshirjes ku në mënyrë të veçantë anëtarët e dy komuniteteve ndihen të përfaqësuar përmes anëtarëve të vetë komunitetit në grupin e punës. Procedurat e ndjekura në hartimin e planit sigurojnë gjithashtu një model transparent të demokracisë pjesëmarrëse, ku vetë komuniteti ndihet i mirëdëgjuar përsa i përket vendimeve të cilat do të influencojnë dhe ndikojnë padyshim në vetë cilësinë dhe mirëqenien e jetës së tyre.

6. Barazia para ligjit dhe parimi i mosdiskriminimit:

Të gjitha aktivitetet e planifikuara në kuadër të Planit të Veprimt do të kenë në qendër të vëmendjes së tyre respektimin e të drejtave dhe garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit para ligjit. Parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit qëndrojnë në themel të Kushtetutës së Shqipërisë (neni 18) si edhe në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, të vitit 1948 (neni 2). Sipas këtij parimi, çdo individ gëzon të drejtat dhe liritë e përcaktuara pa asnjë kufizim përsa i përket gjinisë, racës, gjuhës, përkatësisë fetare, mendimit politik, origjinës kombëtare e shoqërore, pasurisë, përkatësisë në një minoritet kombëtar, lindjes ose çdo status tjetër social ekonomik apo arsimor.

Modeli konceptual: Hartimi i planit të zhvillimit të komunitetit

Faza përgatitore

Vlerësimi i komunitetit

HAPI 1: Identifikimi i aktorëve

HAPI 2: Garantimi i angazhimit politik

HAPI 3: Ofrimi i mbështetjes teknike dhe ngritja e grupeve të punës dhe nën-grupeve të punës

HAPI 4: Mbledhja e informacionit

HAPI 5: Mobilizimi i komunitetit

HAPI 6 - Të dhënat: Fushat prioritare të planit

- 1- Regjistrimi civil dhe aksesimi në drejtësi
- 2- Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor
- 3- Punësimi, arsimi dhe formimi profesional
- 4- Kujdesi shëndetësor
- 5- Strehimi dhe integrimi urban
- 6- Mbrojtja sociale

HAPI 8:

Analiza,
sintetizimi i të
dhënave

HAPI 7:

Pema e
problemeve

SWOT

HAPI 9:

Ofrimi i asistencës

- 1- Vizioni
- 2- Qëllimi strategjik
- 3- Objektivat specifik

HAPI 10:

Pema e objektivave

HAPI 11:

Aktivitetet
Institucionet
Periudha kohore
Burimi i financimit
Indikator
Treguesi bazë
Treguesi i synuar 2020
Burimi i të dhënave

HAPI 16:

Monitorim dhe vlerësim

HAPI 15:

Zbatimimi i planit

HAPI 13:

Finalizimi i planit

HAPI 14:

Aprovimi i dokumentit
në këshill

HAPI 12:

Konsultimi me
aktoret e interesit
& publikun



Metodologjia

Për hartimin e Planit të Zhvillimit është përdorur një metodologji kërkimore mikse, sasiore dhe cilësore duke u bazuar në të dhëna parësore dhe dytësore të institucioneve përkatëse në Bashkinë Durrës . Metodologjia kërkimore përfshin: 1) intervista gjysëm të strukturuar ballë për ballë me anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian; 2) Intervista të thelluara me informantë kyç nga institucionet vendore dhe shoqëria civile; 3) fokus grupe me banorë të komuniteteve; 4) sesion i analizës SWOT me anëtarët e nëngrupeve të punës; 4) workshope me grupin e punës duke përfshirë punën në grupe tematike.

Gjatë sesioneve konsultuese me aktivistë nga Komuniteti



Konsultime me Komunitetin



Gjatë sesioneve konsultuese me aktivistë nga Komuniteti



Identifikimi dhe përfshirja e aktorëve kryesorë në zhvillimin lokal është thelbësore për hartimin me sukses të këtij plani zhvillimi. Duke pranuar se çështja e integritit dhe fuqizimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian kërkon një qasje ndërsektoriale, shumëaktorëshe dhe gjithëpërfshirëse për vetë kompleksitetin e sfidave dhe problemeve me të cilat përballen, procesi i draftimit dhe konsultimit të planit ka përfshirë aktorë të ndryshëm si nga sektori publik ashtu edhe ai jo-publik.

Përfshirja e gjerë e aktorëve përgjatë procesit planifikues është një parakusht i domosdoshëm për të krijuar një model të qëndrueshëm, racional dhe vizionar të planit. Kjo qasje kërkon gjithashtu, një përfshirje edhe më të përgjegjshme në procesin e zbatimit dhe monitorimit të planit me qëllim që plani të mos jetë thjesht një dokument statik, por të lejojë fleksibilitetin e ndërhyrjeve në koherencë me zhvillimet/ndryshimet aktuale që paraprin komunitetin. Pra, vizioni për planin është më shumë se një produkt, pasi ai reflekton një qasje më dinamike të mekanizmave institucionalë në nivel vendor për të adresuar/rishikuar me fleksibilitet nevojat në zhvillim.

Grupi lokal me pjesëmarrje i planit të zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian propozohet të ketë përbërjen si më poshtë:

Grupi Lokal me pjesëmarrje të PZHK

Këshilli bashkiak & NJQV

- Të zgjedhurit lokal
- 3-4 anëtarë të Këshillit Bashkiak
- 3-5 administratorë të Njësive Administrative

Stafi kyç i Bashkisë

- Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit
- Drejtoria e financave & buxhetit
- Drejtoria shërbimeve sociale
- Njësia e mbrojtjes së fëmijëve
- Ndhma ekonomike
- Gjendja civile

Përfaqësues të autoriteteve të tjera publike

- Zyra Rajonale e Punësimit
- Zyra Rajonale e Shërbimit Social
- Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik
- Drejtoria Arsimore Rajonale
- Drejtoria e Policisë
- Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të kujdesit shëndetësor, Durrës
- Qendra Shëndetësore

Shoqëria civile & Komuniteti

- 3-5 anëtarë të forumeve të këshillimit të komunitetit
- Përfaqësues nga organizata lokale të shoqërisë civile
- Aktivistë



KAPITULLI 2

ANALIZA E SITUATËS AKTUALE



Në territorin e Bashkisë së Durrësit jetojnë rreth 175,110 banorë në total në 6 Njësi Administrative (Durrës, Sukth, Ishëm, Katund i Ri, Rrashbull dhe Manëz)¹, nga të cilët 2834 banorë i përkasin komunitetit Rom dhe Egjiptian. Në këtë bashki, komuniteti Rom numëron rreth 1.423 banorë (59% femra dhe 41% meshkuj) dhe rreth 1400 banorë² të komunitetit Egjiptian (43% femra dhe 57% meshkuj), të cilët së bashku përfaqësojnë rreth 1.6% të popullsisë totale në këtë bashki³. Ndërkohë, nëse i referohemi shpërndarjes së popullsisë rome në shkallë vendi, rezulton se në Bashkinë Durrës jetojnë rreth 4.6% e totalit të përgjithshëm të romëve⁴. Edhe pse kategorizohen në një grup të vetëm, romët janë të ndarë në 5 nëngrupe apo subkultura (Erl; Meckar; Çergarët; Kallbuxhi; Bamill) që dallojnë nga njëri tjetri nga trajektoret e lëvizjeve, dialekti, koha e

mbërritjes në Shqipëri, profesionet socio-ekonomike, dialektet linguistike, stili i jetesës, dhe zakonet⁵. Në Bashkinë Durrës dominojnë kryesisht pjesëtarë të fisit Meckar, i cili për nga madhësia renditet si nëngrupi i dytë më i madh në raport me popullatën e përgjithshme rome⁶.

Komuniteti Rom në Durrës është i përqëndruar më së shumti në zonën e Nishtullës, ku banojnë rreth 127




Figura 1. Familjet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Durrës
Burimi: Bashkia Durrës, 2017

1. INSTAT. (2011). Popullsia sipas Census 2011.Tirane <http://zgjedhje2015.reporter.al/wp-content/uploads/2015/05/Bashkia-Durr%C3%ABs.pdf>
2. Nuk ka të dhëna për egjiptianët që jetojnë në Njësitë Administrative 1,2 ,3 në Bashkinë e Durrësit
3. Bashkia Durrës (2017).Për shkak të natyrës migratore të lëvizjeve të komunitetit rom, të dhënat për numrin e banorëve dhe vendbanimet rome variojnë nga njëri burim në tjetrin.
4. OSFA(2014) Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri.
5. Gëdeshi, I. & Miluka, J. (2012). Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri. UNDP.
6. UNICEF.(2011). Social Inclusion Data for Children in Albania : Roma Communities. <http://www.sidalbania.org/romamap.php?lang=en&pg=romabyregion&m=view®=Durre>

familje rome⁷, të vendosura aty prej më shumë se 60 vitesh⁸. Një pjesë e rëndësishme e vendbanimeve rome është e përqëndruar gjithashtu në zonën Kulla, Xhafzotaj, Rrashbull dhe Fllakë⁹. Ndërkohë, rreth 320 familje egjiptiane janë të përqëndruara kryesisht në njësitë administrative 2 dhe 4, zonë e njohur ndryshe si Çezma e Ferrës, Ish fidanishtja dhe Spitalla, si dhe në Nj.A Nr.3, në zonën e Kënetës, Kullës dhe Nishtullës¹⁰.

Edhe pse prej shumë vitesh ekziston një bashkëjetesë harmonike e këtij komuniteti me mazhorancën e popullsisë¹¹, marginalizimi mbetet ende një problem shqetësues në ditët e sotme. Ndryshe nga romët, egjiptianët paraqesin relativisht shkallë më të lartë integrimi socio-ekonomik në shoqëri. E megjithatë të dy grupet përballen në mënyrë të vazhdueshme me qëndrime dhe praktika stigmatizuese duke krijuar kështu një hendek të thellë pabarazie me popullsinë shumicë.

Familjet rome dhe egjiptiane kanë nivele më të larta të varfërisë krahasuar me popullsinë shumicë, shprehur kjo në pamundësinë për të përmbushur edhe nevojat materiale më minimale jetike në jetën e përditshme si ushqimi, veshja apo strehimi. Për sa i përket kushteve socio-ekonomike, në qytetin e Durrësit, rreth 69.9% e familjeve rome dhe 79.2% e familjeve egjiptiane bëjnë pjesë në grupin “shumë e varfër”¹². Komunitetet Rome dhe Egjiptiane edhe pse kanë shkallë të lartë të papunësisë (rreth ¾ e popullsisë rome në moshë pune janë të papunë)¹³ kanë më pak gjasa të regjistrohen si

7. Të dhënat nga Qendra Kombëtare për Studime Sociale & W&P Infrastruture Consultants, 2016, vlerësojnë rreth 145 familje në këtë zonë.

8. UET Centre (2016). Engagement of Roma communities with Local Government in Albania: Ways to move forward. Tirana.

9. Sipat të dhënave zyrtare nga Bashkia Durrës, 2017; & Qendra Kombëtare për Studime Sociale & W&P Infrastruture Consultants (2016). Një studim mbi vendbanimet me standarte nën normë, të romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë e Durrësit me qëllim vlerësimin e nevojës për investime në përmirësimin e kushteve të banimit dhe jetesës së këtyre komuniteteve; Takim i Anëtarëve të Grupit të Punës së PZHk, “Vizioni, qëllimet strategjike dhe matrica e planit të veprimit për zhvillimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian”, date 31 Maj 2017, Durrës

10. Sipat të dhënave zyrtare nga Bashkia Durrës, 2017; Qendra Kombëtare për Studime Sociale & W&P Infrastruture Consultants (2016); Takim i Anëtarëve të Grupit të Punës së PZHk, date 31 Maj 2017, Durrës

11. Komisioni Europian, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/albania/ipa/2015/20160126-economic-and-social-empowerment-of-roma-and-egyptian-communities.pdf>

12. Gëdeshi, I., Mykerezhi, P. & Danaj, E. (2016). Hartëzimi i aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkitë e Tiranës, Durrësit, Beratit dhe Shkodrës. UNDP, Tirane

13. OSFA (2014)

punëkërkuës (vetëm 1/8 e të papunëve të pyetur në studimin e IDM(2017) janë të regjistruar si të papunë në zyrat e punës. Burimet kryesore të të ardhurave për të dy komunitetet janë punët e rastit, remitancat e emigrantëve si dhe grumbullimi i hekurishteve dhe kanaçeve, shitja e rrobave të përdorura dhe lypja në një masë më të madhe për romët. Niveli i ulët arsimor (në Bashkinë Durrës vlerësohet mesatarisht 2.7 vite shkollim për romët)¹⁴ dhe punësimi kryesisht në sektorët informalë janë faktorë që reflektojnë në një farë mënyre jo vetëm gjëndjen e ulët socio-ekonomike, por edhe qasjen pasive që ky komunitet ka në përgjithësi ndaj shërbimeve sociale dhe shëndetësore. Për më tepër, përjashtimi nga jeta sociale dhe ekonomike e rrit akoma më shumë hendekun e këtyre komuniteteve me popullsinë shumicë. Problemet që shqetësojnë komunitetin Rom dhe Egjiptian në Durrës janë nga më të shumtat duke kryesuar me papunësinë, anafabetizmin, problemet shëndetësore e duke vijuar më tej me kushtet e këqia të jetesës dhe infrastrukturën e keqe, aksesin e ulët në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe të strehimit. Ndërkaq, niveli i lartë i varfërisë i ndikuar nga faktorë të tjerë predispozues si kushtet e vështira të jetesës, kequshqyerja, mungesa e një strehimi të sigurtë dhe higjenes rrit akoma më shumë gjasat që komuniteti Rom dhe Egjiptian të ndihet më i rrezikuar për sa i përket shëndetit apo integritit socio-ekonomik në shoqëri.

Rubrikat në vijim ofrojnë një panoramë të përgjithshme të situatës aktuale të komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit sipas 6 fushave prioritare të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, të cilat janë: rregjistrimi civil dhe aksesin në drejtësi, arsimimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor, kujdesi shëndetësor, punësimi dhe formimi profesional, strehimi dhe integrimi urban si dhe mbrojtja sociale.

14. UNICEF (2011)

1. Regjistrimi civil dhe aksesimi në sistemin e drejtësisë

1.1 Regjistrimi civil për komunitetin Rom dhe Egjiptian (në një masë më të vogël) mbetet një problem madhor, kjo për shkak të jetës së tyre kryesisht në lëvizje, mungesës së informacionit, kushteve të vështira financiare, martesave të hershme të cilat zhvillohen në mënyrë tradicionale dhe nuk shoqërohen me aktin e regjistrimit në Zyrën e Gjendjes Civile. Sipas ekspertëve ligjorë të organizatës TLASS¹⁵ janë të paktën 200 raste të identifikuar nga këto komunitete që kërkojnë ndihmë për regjistrim civil, prej të cilave 28 raste janë të përqendruara në Kulla dhe rreth 60 raste janë për t'u ndjekur në formën gjyqësore¹⁶. Edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare për numrin banorëve romë dhe egjiptianë të paregjistruar në Bashkinë e Durrësit, sipas të dhënave nga studimi i zhvilluar në terren me anëtarë të të dy komuniteteve nga IDM (2017) rezulton se rreth 12% e të intervistuarve dhe 19.5% të anëtarëve të familjarëve të tyre nuk figurojnë të regjistruar në regjistrin e gjendjes civile. Disa nga arsyet e përmendura nga të intervistuarit si pengesa kryesore në regjistrimin civil janë: lëvizjet migratore të shpeshta nga njëri qytet në tjetrin, burokracitë institucionale, të ardhura të pamjaftueshme; mungesa e dokumentacionit si çertifikata e pronësisë ose kontrata e qirasë së banesës në bashkinë ku janë transferuar, mungesa e informacionit të duhur mbi procedurat; regjistrimi në një qytet tjetër; lindjet jashtë sistemit shëndetësor, lindjet jashtë vendit dhe pengesa në transferimin e dokumentacionit si edhe martesat e hershme.

Regjistrimi civil është një e drejtë themelore përmes të cilit, çdo person siguron njohjen para ligjit duke ushtruar të drejtat dhe liritë e tyre. Sipas intervistave në terren të zhvilluara nga IDM (2017), rezulton se rreth 67.6 % e të anketuarve mendojnë se regjistrimi në gjendjen civile nuk është problem, ndërkohë vetëm 20.8% e të pyeturve në këtë komunitet e vlerësojnë çështjen e regjistrimeve në zyrën e gjendjes civile si shumë

15. Organizata TLASS është kontraktuar nga projektiti ESERE i UNDP për zbatimin e modelit të shërbimeve të integruara sociale me bazë në komunitet

16. Takim i Anëtarëve të Grupit të Punës së PZHK, date 31 Maj 2017, Durrës

problematike. Edhe pse regjistrimi civil përbën një mekanizëm të rëndësishëm për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të njeriut, të dhënat e mësipërme tregojnë se ka një mungesë të thellë njohurie rreth rëndësisë së regjistrimit në regjistrin civil dhe si rrjedhim, mungesë informacioni për të drejtat dhe përfitimet që rrjedhin automatikisht nga regjistrimi në gjendjen civile.

1.2 Ndhimja ligjore falas

Aktualisht, nisma ligjore për regjistrimin e komunitetit në regjistrin civil dhe ofrimin e asistencën ligjore falas për një periudhë 1-vjeçare (Prill 2017-Mars 2017), realizohet nga organizata NCCS, e kontraktuar nga UNDP për zbatimin e modelit të shërbimeve të integruara sociale me bazë në komunitet¹⁷. Problematikat kryesore lidhur me këtë çështje kanë të bëjnë me rastet e regjistrimit të fëmijëve në gjendjen civile, raste divorcesh, probleme me legalizimin e banesave, zhvendosje rezidence, persona të cilët nuk janë pajisur me karta identiteti dhe hasin probleme me strehimin, ndihmën sociale dhe ekonomike. Në lidhje me ofrimin e ndihmës ligjore falas për problemet e sapo cituara, rezulton se rreth 80.7% e anëtarëve të intervistuar nuk e njohin këtë shërbim dhe nuk kanë kërkuar informacion dhe vetëm 1% kanë përfituar nga asistenca ligjore. Disa nga arsytet që përmenden për mospërfitimin e ndihmës ligjore janë: mungesa e të ardhurave financiare; mungesë aksesit në informacion; refuzim i ndihmës nga punonjësit. Referuar kompleksitetit të problemeve që shqetësojnë këto komunitete, vazhdimësia dhe qëndrueshmëria e ndihmës juridike falas përbën një hap të rëndësishëm në adresimin e sfidave ligjore të këtij komuniteti. Të dhënat e studimit të IDM (2017) tregojnë se vështirësitë e komunitetit Rom dhe Egjiptian në përballje dhe në komunikimin me institucionet vendore kanë të bëjnë me qëndrimin dhe sjelljen

17. Projekti EVLC i UNDP i zbatuar në qarkun Durrës më 2010-2013 gjithashtu adresonte çështjen e regjistrimit, përmes organizatave të kontraktuara nga UNDP, si Tlas dhe Amaro Drom. Organizata të tjera si USHTEN, kanë referuar raste për asistencë ligjore.

diskriminuese ndaj këtij komuniteti. Rreth, $\frac{3}{4}$ e të intervistuarve pohojnë se janë përballur me ofendime dhe diskriminime nga institucionet vendore. Në lidhje me këtë çështje të intervistuarit shprehen se disa nga format e diskriminimit marrin trajtën e formave indirekte dhe të fshehura të diskriminimit të tilla si vonesa apo burokraci në procedura të caktuara. Ndër format më të dukshme dhe direkte të diskriminimit përmenden ofendimet verbale, kryesisht për shkak të etnisë (23.9% e të anketuarve), ngjyrës (17.7%), arsimimit dhe higjienës jo të duhur, perceptimit si inferior etj. Edhe pse marrëdhëniet sociale pozitive të këtyre komuniteteve me popullsinë shumicë në Bashkinë e Durrësit reflektojnë deri diku shkallën e pranimit të tyre në shoqëri përsëri prirjet segreguese dhe diskriminuese ndaj tyre, ashtu sikurse konfirmohen nga perceptimet e të pyeturve në studim, vazhdojnë të ushqehen ende nga një pjesë e shoqërisë.

2. Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor

Shkalla e regjistrimit të individëve romë dhe në një masë më të vogël atyre egjiptianë në sistemin arsimor në Bashkinë Durrës vazhdon të mbetet më e ulët në raport me popullsinë shumicë. Në dallim nga komuniteti Egjiptian, komuniteti Rom karakterizohet nga një shkallë e ulët e frekuentimit të institucioneve arsimore, duke rritur ndjeshëm shkallën e analfabetizmit të kjo popullatë, e cila sipas studimeve në Bashkinë Durrës vlerësohet të ketë mesatarisht rreth 2.7 vite mesatare shkollimi¹⁸.

Për më tepër, situata e vështirë ekonomike i detyron fëmijët të braktisin shkollën në një moshë shumë të hershme për të siguruar të ardhura për familjet e tyre. Ndërkohë që mendësitë patriarkale dhe konservatore të vetë familjeve përbëjnë grupin e faktorëve shtytës të cilët rrisin ndjeshëm hendekun gjinor duke shkakuar probleme serioze të braktisjes së shkollës nga vajzat. Mungesa e arsimit mund të konsiderohet si një disavantazh që kufizon ndjeshëm integrimin e individëve në tregun e punës dhe


18. UNICEF (2011)

për rrjedhim ndikon negativisht në situatën tejet të pafavorshme socio-ekonomike të këtij komuniteti.

2.1 Arsimi parashkollor

Situata e regjistrimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë në sistemin parashkollor publik, paraqitet dukshëm më e ulët, veçanërisht për romët. Ndonëse, nxitja e të mësuarit gjatë fëmijërisë së hershme është një element shumë i rëndësishëm i arsimit parashkollor, të dhënat tregojnë një situatë të përkeqësuar për sa i përket regjistrimit dhe frekuentimit nga ana e fëmijëve romë dhe egjiptianë. Sipas të dhënave¹⁹ numri i kopshteve që operojnë në Bashkinë Durrës për vitin 2016-2017 arrin në 76.

Figura.2. Numri i fëmijëve romë në arsimin parashkollor 2011-2017
Burimi: DAR, 2017; UNICEF, 2011



I njëjti burim zyrtar konfirmon se numri i fëmijëve romë frekuentues të arsimit parashkollor ka ardhur në rënie në 3 vitet e fundit (referojuni tabelës nr.2). Ndërkohë për vitin 2016-2017, numri i fëmijëve egjiptianë, frekuentues të arsimit parashkollor arrin në 124. Nëse i referohemi të dhënave të frekuentimit

19. Burimi i të dhënave për vitet 2011,2014 është UNICEF, 2011 & për të dhënat e viteve 2014-2015;2015-2016;2016-2017 është DAR Durrës.

të arsimit parashkollor nga fëmijët e komunitetit Rom dhe Egjiptian në kopshtin publik në Kullë, vetëm 5 fëmijë janë frekuentues për vitin 2016-2017²⁰. Ndërkohë, sipas të dhënave nga vetë deklaratimet e komunitetit, në zonën Çezma e Ferrës nga 200 fëmijë të regjistruar në kopësht, vetëm 46 fëmijë janë aktualisht nga komuniteti Egjiptian²¹. Këto të dhëna tregojnë qartazi se përpos përpjekjeve që janë bërë për të rritur ndjeshmërinë ndaj aspekteve pozitive dhe përfitimeve të arsimit parashkollor kryesisht të komuniteti Rom, braktisja vazhdon të mbizotërojë si një problem dominues.

2.2 Arsimi bazë

Arsimi bazë është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët që janë shtetas shqiptarë me banim në Republikën e Shqipërisë, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar²². Megjithatë, përfshirja e fëmijëve romë në arsimin bazë ngelet ende një nga sfidat për integrimin e tyre. Sipas të dhënave zyrtare nga DAR Durrës, rezulton se numri total i fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin bazë për vitin 2016-2017 është 176 romë dhe 694 egjiptianë. Sipas DAR Durrës, 89 fëmijë kanë braktisur shkollën për vitin 2016- 2017, prej të cilëve 35 femra dhe 54 meshkuj. Nuk ka të dhëna për braktisjen nga fëmijët e komunitetit Rom dhe Egjiptian²³. Ndërkohë, në vitin 2016, sipas të dhënave të studimit të kryer në Bashkinë Durrës nga Gëdeshi et al.(2016) vetëm 50% e fëmijëve romë dhe 70.6% e fëmijëve egjiptianë të grup-moshës 8 deri 15 vjeç ndjekin shkollën, kundrejt 32.1% e fëmijëve romë dhe 5.9% e fëmijëve egjiptianë që kanë braktisur shkollën. Rreth 17.9% e fëmijëve romë dhe 23.5% e fëmijëve egjiptianë të grup-moshës 8 deri 15 vjeç nuk kanë shkuar asnjëherë në shkollë. Nëse i referohemi vetëm të dhënave të shkollës së

20. Të dhëna zyrtare nga Njësia Administrative Sukth

21. Të dhëna të ofruara nga Takimi i Grupit të Punës së PZHK, datë 31 Maj 2017, Durrës

22. Neni 22, Neni 5, Ligj Nr. 69/2012 Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë

23. Burime dhe studime të ndryshme reflektojnë një mospërputhje të të dhënave në lidhje me frekuentimin e shkollës dhe fenomenin e braktisjes së shkollës nga nxënësit rom dhe egjiptian.

Bashkuar në Kullë, në Njësinë Administrative Sukth, evidentohet se vetëm për vitin 2016-2017 nga 52 fëmijë të regjistruar në arsimin bazik (35 romë dhe 17 egjiptianë), $\frac{3}{4}$ e fëmijëve romë rezultuan të jenë braktisës²⁴. Në dallim nga komuniteti Egjiptian, romët paraqesin një shkallë më të lartë të braktisjes së shkollës.

2.3 Arsimi i mesëm

Të dhënat nga DAR Durrës konfirmojnë se rreth 22 fëmijë romë dhe 39 fëmijë egjiptianë janë të regjistruar në arsimin e mesëm në Bashkinë Durrës.

2.4 Arsimi i lartë

Sipas studimeve të kryera, mendohet se vetëm 0.3% e romëve kanë arsim të lartë²⁵. Nuk ofrohen të dhëna zyrtare të ndara sipas bashkive.

Braktisja e shkollës/ kopshtit

Në vijim rezultatet e studimit nga IDM (2017) tregojnë se rreth 34.1% e të anketuarve pohojnë se fëmijët e tyre nuk shkojnë në shkollë/kopshte. E megjithatë shifrat janë akoma më shqetësuese nëse i referohemi braktisjes së shkollës/kopshtit nga fëmijët e këtij komuniteti, ku rreth 81.1% vetëraportojnë se ka braktisje të shkollës nga fëmijët e komunitetit të tyre. Pra, sikurse u evidentua më sipër, problematikat që shoqërojnë situatën arsimore të këtij komuniteti kanë të bëjnë me braktisjen e institucioneve si në arsimin 9-të vjeçar dhe në një frekuencë më të lartë në atë parashkollor. Megjithatë, vijueshmëria fizike në shkollë nuk reflekton një arsim cilësor për nxënësit që vijnë nga komuniteti Rom dhe Egjiptian. Mungesa e duhur e vëmendjes nga mësuesit dhe rezultatet tepër të dobëta të nxënësve

24. Të dhëna zyrtare nga Njësia Administrative Sukth

25. Gedeshi, I., Janku, A., Shehi, E. (2006). Albanian Roma Report: At Risk. The social vulnerability of Roma in Albania Tirana. UNDP

Nisma për integrimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë në sistemin arsimor

Mosfunksionimi i 'Shansit të dytë', program për arsimimin e nxënësve që kanë braktisur shkollën që prej viti 2013, penalizon akoma më shumë kontigjentin e fëmijëve të cilët e kanë braktisur shkollën vite më parë apo ata të cilët nuk janë regjistruar asnjëherë në sistemin arsimor bazë . Këta fëmijë, përpos dëshirës për tu integruar dhe vijuar arsimin bazë, përjetojnë një sërë problemesh emocionale dhe paragjykimesh, për shkak se rikthimi në po të njëjtën klasë që kanë braktisur vite më parë (mosha mendore) nuk përkon me moshën e tyre fizike. Të ndodhur përball një fenomeni të tillë, këta fëmijë detyrohen të braktisin shkollën brenda një kohë shumë të shkurtër.

në shkollë çojnë në braktisjen e fshehtë e shkollës dhe fenomenin e analfabetizmit pasiv. DAR nuk disponon shifra për braktisjen e fshehtë megjithëse shkolla bën kurse për nxënësit me rezultate të ulta.

2.5 Vetë-perceptimi mbi nivelin arsimor

Si e vlerësoni nivelin arsimor në komunitetin tuaj?




Figura. 3. Vetëvlerësimi i nivelit arsimor
Burimi: Anketa e IDM (2017)

Të pyetur vetë anëtarët e komunitetit se si e vlerësojnë ata nivelin arsimor të tyre, rezulton se pjesa më e madhe e të anketuarve 39.4% janë shprehur mirë dhe shumë mirë; 27.6 % janë shprehur keq; 25.5% mesatarisht; dhe vetëm 7.4 % e vlerësojnë shumë keq (IDM, 2017). Sikurse mund të evidentohet, ka një shpërndarje pothuajse mesatare për sa i përket vetë-perceptimit mbi nivelin arsimor midis personave që mendojnë keq; mesatarisht dhe mirë. Përpos, shkallës së lartë të analfabetizmit të këtij komuniteti, të dhënat e mësipërme dëshmojnë deri diku për një vetë-perceptim disi më pozitiv, fenomen i njohur si vetë-dëshirueshmëri sociale kundrejt realitetit alarmant të nivelit arsimor.

2.6 Pengesat në lidhje me arsimimin

Pengesat kryesore që hasin prindërit romë dhe egjiptianë në lidhje me arsimimin e fëmijëve të tyre kanë të bëjnë me një sërë faktorësh ku kryesisht mbizotëron varfëria, mungesa e mundësive financiare. Të tjerë faktorë pengues që hasin vetë fëmijët e komunitetit Rom dhe Egjiptian janë: mungesa e theksuar e interesit për vazhdimin e shkollës, punësimi i fëmijëve me qëllim për të kontribuar në të ardhurat e familjes si dhe arsimimi i ulët i prindërve tyre. Porë në këndvështrimin gjinor, praktika e martesave të hershme të vajzave dhe përforcimi i roleve tradicionale gjinore në lidhje me përkujdesjen familjare dhe punët e shtëpisë, rrit akoma më shumë hendekun gjinor në arsim.

Sipas Censurit të 2011 nga INSTAT, rreth 96% e vajzave dhe 68% e djemve romë në moshën 16 vjeç kanë braktisur shkollën. Megjithatë, përpos mosdisponueshmërisë së të dhënave zyrtare të disegreguara sipas gjinisë në lidhje me frekuentimin e arsimit parauniversitar, në Bashkinë Durrës, hendeku gjinor është i evidentueshëm. Të dhënat në shkollën Isuf Ferra në Bashkinë Durrës, tregojnë se vetëm 34.5% e fëmijëve të regjistruar janë vajza dhe rreth 65% janë djem, ndërkohë sipas DAR Durrës, rreth 45% e fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin bazë i përkasin gjinisë femërore²⁶. Për më tepër që ka një lidhje të drejtëpërdrejtë të nivelit arsimor me gjëndjen e banesës ku jetojnë familjet. Sipas studimit të OSFA (2014), rezulton se 80% e individëve romë që nuk kanë njohuri në shkrim dhe lexim jetojnë në banesa të llojit kasolle (e rrethuar me dërrasa, llamarinë apo plasmas). Në një këndvështrim kritik, dhe referuar të dhënave²⁷ ku 97% e banesave të komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Durrës, nuk përmbushin kushtet higjieno sanitare, mund të themi se infrastruktura e papërshtatshme e banesave reflekton deri diku nivelin e ulët arsimor.

Të pyetur mbi shkaqet që cilat çojnë në braktisjen e shkollës të fëmijët romë

26. Intervistë me informante kyç, 5 Prill 2017, Shkolla Isuf Ferra, Durrës

27. Qendra Kombëtare për Studime Sociale & W&P Infrastruktura Consultants (2016)

dhe egjiptianë, pjesa më e madhe e të anketuarve (49%), kanë vlerësuar se rezultatet e dobëta në mësim dhe pamundësia për të ndjekur shkollën janë dy nga arsyet kryesore që ndikojnë shumë në braktisjen e shkollës. Në përgjithësi, duke patur një nivel arsimor shumë të ulët, prindërit mund të mos jenë në gjendje t'u japin fëmijëve të tyre përkrahjen e nevojshme për kryerjen e detyrave shkollore. Një tjetër faktor që ndikon ndjeshëm në braktisjen e shkollës dhe për pasojë në rezultate më të ulta në mësim, është emigrimi i shpeshtë i familjeve jashtë Shqipërisë. Fëmijët detyrohen të braktisin shkollën dhe kur kthehen ata kanë probleme me integrimin në procesin arsimor, pasi mbeten mbrapa në mësim. Gjithsesi DAR²⁸ e ka zgjidhur këtë problem nëpërmjet një komisioni të posaçëm i cili i vlerëson se në çfarë klase duhet të shkojnë fëmijët e kthyer. Për të adresuar këtë problematikë, PNUD përmes projektit ESERE, ka hartuar tashmë një kurrikul të hartuar enkas për të punuar me të rritur analfabetë. Në vijim, janë ndërmarrë aktivitete të tjera shtesë për të trajnuar mësues për të aplikuar programin në mënyrën e duhur.

Sipas, IDM (2017), një masë e konsiderueshme e të anketuarve (68.1%) vlerëson se qëndrimet diskriminuese ndaj fëmijëve Romë & Egjiptianë ndikojnë disi në braktisjen e shkollës. Qëndrime të tilla diskriminuese ndaj fëmijëve mund të ulin vetëbesimin e këtyre fëmijëve dhe për rrjedhojë kjo mund të reflektohet në performancën e ulët në mësim. Ndërkohë që nevoja për të mbështetur prindërit për të fituar para për jetesën është vlerësuar se ndikon 'shumë' dhe 'jashtëzakonisht shumë' nga 50.7% dhe 'disi' nga 41.6% (IDM, 2017). Të dhënat e mësipërme hedhin dritë gjithashtu mbi fenomenin negativ të punës së fëmijëve, faktor i cili ndikon në masën më të madhe në braktisjen e shkollës. Edhe pse janë organizuar aktivitete nga organizata të ndryshme për gërshetimin e kulturave, traditave të këtyre komuniteteve, specialistët e DAR, shprehen se këto shoqata bëjnë

28. Intervistë me DAR Durrës, 5 Prill 2017; Në zbatim të Udhëzimit Nr 44 datë 21.08.2013 "Per percaktimin e kriterëve dhe procedurave të njevlshmerisëse deftesave dhe diplomave te nxenesve te arsimit parauniversitare ardhur nga jashte vendit"

Nisma për integrimin e fëmijëve Romë dhe Egjiptianë në sistemin arsimor

Mosfunksionimi i 'Shansit të dytë', program për arsimimin e nxënësve që kanë braktisur shkollën që prej viti 2013, penalizon akoma më shumë kontigjentin e fëmijëve të cilët e kanë braktisur shkollën vite më parë apo ata të cilët nuk janë regjistruar asnjëherë në sistemin arsimor bazë. Këta fëmijë, përpos dëshirës për tu integruar dhe vijuar arsimin bazë, përjetojnë një sërë problemesh emocionale dhe paragjykimesh, për shkak se rikthimi në po të njëjtën klasë që kanë braktisur vite më parë (mosha mendore) nuk përkon me moshën e tyre fizike. Të ndodhur përballë një fenomeni të tillë, këta fëmijë detyrohen të braktisin shkollën brenda një kohë shumë të shkurtër.

një punë të pamjaftueshme në adresimin e problemeve dhe riintegrimin arsimor të këtij komuniteti.

2.7 Vetëperceptimi mbi skenarët e ndihmës:

Anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian janë pyetur për skenarët e mundshëm se si mund të ndihmohen më shumë fëmijët e tyre për të ndjekur shkollën. Kështu, sipas rezultateve, 51% e të anketuarëve sipas studimit nga IDM (2017) kanë sugjeruar ndihmën me tekste shkollore falas. Edhe pse tekstet shkollore ofrohen falas për fëmijët e Komuniteteve romë dhe egjiptiane, pjesa më e madhe e të anketuarve mund të mos jenë në dijeni të një informacioni të tillë. Nga ana tjetër të sipas burimeve nga DAR Durrës, ligji për librat falas për komunitetin Rom është një praktikë pozitive që është zbatuar²⁹.

Gjithsesi kjo iniciativë nuk është e mjaftueshme, duke qenë se këtij komuniteti u duhen dhënë dhe mjetet mësimore, fletore, veshje, ushqim, etj. Problemi është se ky komunitet ka një mungesë të theksuar iniciativë për të kërkuar të drejtat e tyre. Për aq kohë sa pjesa më e madhe e këtij komuniteti jeton në varfëri ekstreme, duke u përballur në mënyrë të vazhdueshme me përjashtimin social, hezitimi për të kërkuar të drejtat do të vazhdojë të mbizotërojë ndjeshëm te ky komunitet. Sipas të dhënave nga DAR, fëmijët romë dhe egjiptianë nuk kanë hasur probleme me regjistrimin në shkollë edhe në rastet ku nuk kanë paraqitur çertifikata, apo dokumente të tjera që nevojiten për regjistrimin e fëmijëve në shkollë, megjithëse ka një numër të konsiderueshëm që nuk shkojnë dot në shkollë pasi kanë kaluar moshën³⁰. Ndërkohë, rreth 13.8% e të anketuarve (IDM, 2017) mendojnë se fëmijët mund të nxiten nëpërmjet ofrimit të teksteve, transportit falas dhe ndihmës jashtë shkolle për detyrat. Edhe

29. Udhezimi i përbashkët Nr 35 date 14.09.2015" Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e përbashkët Nr 51 datë 20.09.2013 të ministrit të arsimit dhe ministrit të financave për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për batim shtypjen shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar"

30. Në arsimin parauniversitar moshë sipas DN moshë e detyrimit shkollor është 16 vjeç pas kësaj moshe dalin nga detyrimi shkollor.

pse rezultatet e dobëta në mësim vlerësohen si ndër faktorët primarë që ndikojnë në braktisjen e shkollës nga fëmijët, ndihma jashtë shkolle për detyrat e shtëpisë vlerësohet pothuajse si e parëndësishme duke mos u konsideruar nga të anketuarit.

Një vlerësim i tillë hedh dritë mbi qasjen që kanë në përgjithësi pjesëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian ndaj rëndësisë së arsimit.

Në përgjithësi mund të themi se prindërit të cilët kanë nivele të ulëta të arsimimit nuk janë të vetëdijshëm për rëndësinë e arsimit në mirëqënien e fëmijëve të tyre dhe për rrjedhojë mund t'i dekurajojnë ata të ndjekin rrugën arsimore. Megjithëse, ekzistojnë modele pozitive të punësimit të të rinjve³¹ pas përfundimit të arsimit, të punësuar gjatë ose pas studimeve universitare, më shumë duhet punuar në promovimin e tyre në gjithë komunitetin.

2.8 Kushtet e mësimdhënies

Të pyetur vetë anëtarët e komunitetit se si i vlerësojnë ata kushtet e ofrimit të mësimdhënies në kopshtin ku shkojnë fëmijët e lagjes së tyre³² (IDM, 2017) rezulton se 43.8% e të anketuarve janë shprehur mesatarisht. Pothuajse gjysma e të anketuarëve (52.1%) janë shprehur me të njëjtat tone rreth mësimdhënies në shkollë. Edhe pse kushtet e kopshteve dhe të shkollave në lagje janë vlerësuar mesatarisht, ka një braktisje të theksuar të kopshteve dhe shkollave nga fëmijë të këtij komuniteti.

Në lidhje me frekuentimin e shkollës/kopshtit, pjesa më e madhe e të anketuarëve pohojnë faktin se shkolla/kopshti frekuentohet si nga fëmijët romë dhe egjiptianë po ashtu dhe nga jo romë dhe egjiptianë (IDM, 2017). Ky është një tregues i rëndësishëm i integritimit me popullsinë shumicë ku fëmijët ndihen të pranuar në një shkollë më të lartë. Nga ana tjetër studimet kanë treguar se integrimi i komuniteteve jo shumicë është më i

31. Në qëndren komunitare në Nishtulla janë punësuar 4 praktikante Rome me kohe të plote që vazhdojnë studimet e larta, 1 mediator komunitati Rom me kohe të pjesshme dhe 1 anetare e komunitetit egjiptian që ka mbaruar sistemin bachelor

32. Të intervistuar në zonat sipas apendiksit Nr. 1

qëndrueshëm dhe konsiderueshëm më i lartë në hapësira të përbashkëta që lejojnë ndërveprim dinamik me popullsinë shumicë (Çeka & Kaçiu, 2015). Sipas të dhënave nga DAR Durrës, , Shkolla "Isuf Ferra" ka një numër më të lartë të fëmijëve të komunitetit Rom, në krahasim me shkollat e tjera. Nga 510 nxënës në total, rreth 81 fëmijë i përkasin komunitetit Rom. Megjithatë edhe pse shkolla ofron shërbimin e arsimit parashkollor, nuk ka fëmijë nga komuniteti Rom që frekuentojnë kopshtin pasi ata frekuentojnë kryesisht qendrën Nehemia. Kjo, vjen si pasojë e kushteve më të mira të kësaj qendre dhe ofrimit të ushqimit.

2.9 Promovimi i dialogut ndërkulturor

Edhe pse çdo nxënës i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim³³, arsimi cilësor nënkupton edhe veprimtaritë jashtëkurrikulare apo në komunitet të cilat synojnë ndërgjegjësimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor. Aktivitete të tilla duhet të fillojnë së pari brenda ambienteve të shkollës dhe me stafin mësimor, e më tej me anëtarët e komunitetit.

Anketimi i zhvilluar nga IDM (2017)tregon se pjesa më e madhe e të pyeturve vlerësojnë se sjelljet e stafit mësimor/edukativ në shkollën/kopshtin e lagjes së fëmijëve të komunitetit Rom/Egjiptian janë të një natyre të mirë dhe pozitive, kundrejt vetëm 4.3% të cilët kanë shprehur një qëndrim më negativ, duke i kategorizuar këto marrëdhënie si të këqija.

33. Neni 6, Ligj Nr. 69/2012 Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë

Si do ta vlerësonit sjelljen e stafit mësimor/edukativ në shkollën/kopshtin e lagjes suaj ndaj fëmijëve të komunitetit Rom / Egjiptian?




Figura. 4. Vlerësimi i sjelljes së stafit mësimor/edukativ
Burimi: Anketa e IDM (2017)

Të pyetur për arsyet që çojnë në një vlerësim të tillë, përpos sjelljeve pro-sociale dhe mbështetëse të mësuesëve ndaj fëmijëve të këtij komuniteti, disa nga të anketuarit pohojnë se mësuesit kanë shpesh here një qëndrim indiferent, shoqëruar me racizëm, diskriminim për shkak të ngjyrës së lëkurës, trajtim jo të njëjtë dhe të drejtë krahasuar me fëmijët e tjerë, mësimdhënie jo e përkushtuar ndaj këtij komuniteti shoqëruar edhe me ofendime verbale. E megjithatë një pjesë mendojnë se mësuesit nuk kanë ndonjë diferencë në trajtimin e fëmijëve Rom/Egjiptian me fëmijët e tjerë. Në këtë kuadër, për të luftuar dhe adresuar paragjykimet dhe diskriminimet e fshehura kundrejt Komuniteteve rome dhe egjiptiane është e nevojshme rritja e kapaciteteve të vetë stafeve mësimore apo ndërmarrja e aktiviteteve socio-kulturore edukuese në lidhje me promovimin e diversitetit kulturor, mirëkuptimin e përbashkët dhe nxitjen e një mjedisi shkollor gjithëpërfshirës.

3. Punësimi dhe arsimi e formimi profesional (afp)

3.1 Situata e punësimit

Si rezultat i shkallës së ulët të nivelit arsimor, varfërisë dhe përjashtimit social, romët dhe egjiptianët kanë një shkallë më të lartë papunësie, në raport me popullatën shumicë. Në Bashkinë e Durrësit rreth 74% e romëve në moshën eaftë për punë deklarohen të papunë³⁴, shifër kjo tepër e lartë në krahasim me shifrën zyrtare prej 31.6 % të papunësisë së përgjithshme që mbizotëron në qytetin e Durrësit³⁵. Ndërkohë për 2017, numri i personave romë dhe egjiptianë të regjistruar në zyrën e punës është 334³⁶ persona nga 6900 persona të regjistruar ne total³⁷.

Nëse i referohemi të dhënave³⁸ për vitin 2016 rezulton se niveli papunësisë së romëve dhe egjiptianëve në qytetin e Durrësit tejkalon nivelin e papunësisë në të këtyre komuniteteve në qytetin e Tiranës dhe Beratit, ku konkretisht 49.6% e romëve dhe 55.4% e egjiptianëve janë të papunë. Përpos, niveleve të larta të papunësisë së dy komuniteteve në raport me popullsinë shumicë hendequ gjinor për papunësinë për të dy komunitetet në Durrës vijon të jetë edhe më i lartë. Konkretisht, 64.1% e grave romë dhe 64.6% e grave egjiptiane janë të papuna në raport me 35.3% të meshkujve romë dhe 46.2% të meshkujve egjiptianë të papunë³⁹.

Pra, sikurse mund të evidentojmë nga të dhënat më sipër, nga pikëpamja gjinore, niveli i papunësisë te femrat është pothuajse i njëjtë për të dy komunitetet, ndërkohë që niveli i papunësisë së meshkujve egjiptianë është relativisht më i lartë se niveli i papunësisë së meshkujve romë. Ndërkohë, krahas niveleve të larta të papunësisë një pjesë e madhe e banorëve të komunitetit Rom deklarojnë se të ardhurat mujore familjare janë dukshëm me të ulta se

34. OSFA(2014)

35. Tregues i papunësisë si raport i numrit të personave të papunë të moshës 15 vjeç e më shumë ndaj forcës punëtore 15-65 vjeç, sipas INSTAT, Census 2011.

36. Referuar personave që kanë deklaruar etninë

37. Zyra Rajonale e Punësimit

38. Gëdeshi et al. (2016)

39. Po aty

paga minimale (88% vetëdeklarojnë të ardhura poshtë 20 mijë lekë)⁴⁰

Të dhënat e studimit të kryer nga Gëdeshi et al. (2016), tregojnë se 67.8% e romëve (69.9% meshkuj dhe 64.6 % femra) dhe 79.7% e egjiptianëve (86.7% meshkuj dhe 68.9% femra) janë duke kërkuar punë. Interesant është fakti se edhe pse përqindja e femrave rome që kërkojnë punë është pothuajse e njëjtë (relativisht shumë pak e ulët) në raport me meshkujt romë, papunësia e tyre në tregun e punës është pothuajse dy herë më e lartë në krahasim me meshkujt romë. Të dhëna të tilla hedhin dritë mbi pabarazitë dhe diskriminimin e dyfishtë për shkak të etnisë dhe gjinisë të grave rome në tregun e punës. Përqindja e të punësuarve që paguajnë sigurime shoqërore nga komuniteti Rom është 49.1% dhe 79% për komunitetin Egjiptian⁴¹.

3.2 Tipologjia e punësimit

Edhe pse Stratetegjia e Shërbimeve Sociale, nënvizon favorizimin e ndërmarrjeve sociale, ku 30 për qind e punonjësve të punësuar në ndërmarrjet sociale duhet t'i përkasin kategorisë së grupeve të pafavorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike sikurse janë romët dhe egjiptianët, sipas ZRP Durrës vetëm 10 biznese kanë punësuar romë dhe egjiptianë në Bashkinë Durrës. Ndërkohë për vitin 2016, rezultojnë të jenë rreth 9 biznese në Durrës që dëshirojnë të punësojnë romë dhe egjiptianë, kryesisht në aktivitete si fasoneri, industri mekanike, industri plastike dhe industri ushqimore⁴². Edhe pse nga pikëpamja sasiore ky mund të jetë një numër i vogël, duke marrë parasysh totalin e numrit të bizneseve që operojnë në Bashkinë Durrës, është thelbësore që operatorët e biznesit të zhvillojnë një qasje më pozitive ndaj këtij komuniteti. Edhe pse nuk ka të dhëna për tipologjinë e bizneseve që kanë punësuar nga ky komunitet, vlen të theksohen aftësitë që romët zotërojnë në zanate tradicionale si punime me thupra, zejтари, muzikë⁴³.

40. OSFA(2014)

41. Po aty

42. Gëdeshi et al., (2016)

43. Gëdeshi et al., (2016)

3.3 Vlerësimi i gjendjes së punësimit

Anketimi i zhvilluar nga IDM (2017) tregon se rreth 72.5% e të anketuarve e vlerësojnë keq dhe shumë keq gjëndjen e përgjithshme të punësimit për komunitetin, vijuar me 23.1% që janë shprehur mesatarisht, dhe 4.2% shumë mirë. Nga intervistat e realizuara ne anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian, rezulton se rreth 63.8% e tyre nuk kanë një punë të vazhdueshme, ndërkohë që 9.6% prej tyre nuk janë të sigurt për punësimin dhe vetëm 27% kanë punë të vazhdueshme. Pothuajse gjysma e këtij komuniteti janë të punësuar kryesisht në sektorin privat (47%) kundrejt 11.1% që janë punësuar në sektorin publik si edhe 29% janë të vetëpunësuar. Një prej sfidave kryesore në punësimin e këtij komuniteti ka të bëjë me faktin e qëndrueshmërisë në punë, ku vihen re luhajtje të konsiderueshme në mbajtjen e një pune konstante.

3.4 Burimet e të ardhurave

Kryesisht, anëtarë të këtij komunitetit raportojnë se i sigurojnë të ardhurat nëpërmjet punësimit në strukturat e ekonomisë informale apo nëpërmjet vetë-punësimit kryesisht në aktivitete të tilla si tregtimi i rrobave të përdorura (11.5%), mbledhja e materialeve të riciklueshme, kanaceve, bidonave apo skrapit (16.7%)⁴⁴. Një pjesë e të intervistuarve raportojnë se mbijetojnë falë remitancave nga emigracioni, ndihmave të kishës apo marrjes së huasë nga të afërmit. Ky është një tregues i qartë i paqëndrueshmërisë së burimeve të të ardhurave të familjeve romë dhe egjiptiane, gjë e cila çon në degradimin e situatës ekonomike duke kërcënuar vazhdimisht mbijetesën e tyre. Një prej pyetjeve të shtruar në studim synon të nxjerrë në pah nëse punësimi sjell të ardhura të mjaftueshme për të përballuar jetesën e përditshme. Të dhënat tregojnë se për 42.3% punësimi nuk mjafton në sigurimin e të ardhurave minimale. Ndonëse niveli i papunësisë është i lartë për të dy komunitetet, për

44. Po aty

komunitetin Rom burimi më i shpeshtë i të ardhurave ngelen të ardhurat nga puna e rastit (për 39.3% të familjeve), ndërkohë që për komunitetin Egjiptian të ardhurat sigurohen kryesisht nga paga (34.5% e familjeve)⁴⁵. E megjithatë edhe pse burimet e të ardhurave ngelen pothuajse të njëjta për dy komunitetet, lypja ngelet një burim alternativ i të ardhurave për 3.4% të familjeve rome në Bashkinë Durrës. Ndërkohë që një pjesë e vogël e komunitetit Egjiptian (1.2% e familjeve) i siguron të ardhurat nëpërmjet bujqësisë në kundërshtim me romët që raportojnë 0% të ardhura nga bujqësia⁴⁶



Foto ilustruese që tregojnë llojin e punësimit të familjeve në zonën Nishtulla dhe Cezma Ferrës

45. Gëdeshi et al., 2016

46. Po aty

Nëse jeni i papunë, jeni regjistruar si punëkërkuar në zyrat e punës?




Figura. 5.Regjistrimi si punëkërkuar
Burimi: Anketa e IDM (2017)

Të dhënat nga studimi i IDM (2017) evidentojnë se vetëm 12.5% e të anketuarve të papunë janë të regjistruar si punëkërkuar në zyrat e punës, kundrejt 83.7% të cilët nuk janë të regjistruar dhe rreth 3.7% nuk janë në dijeni. Pikërisht, mosregjistrimi në zyrat e punës, ose mosparaqitja e rregullt në zyrat e punës (dhe për pasojë çregjistrimi nga sistemi si punëkërkuar) përbën një barrierë kryesore e cila pengon aksesin ndaj shërbimeve sociale për familjet me të ardhura ekonomike të ulta.

Krahas hezitimit për shkak të arsimit të ulët apo moshës relativisht të lartë për t'u punësuar, të intervistuarit shprehen për mungesën e informacionit lidhur me procedurat dhe aplikimin, mungesën e besimit te zyrat e punës. Ajo çfarë shqetëson tjetër këtë komunitet ka të bëjë gjithashtu me mundësitë shumë të ulëta për punësim në tregun formal të punës. Pas rënies së regjimit komunist, ndryshimet socio-ekonomike dhe politike që shoqëruan periudhën transitore çuan në një rritje masive të papunësisë në përgjithësi për shumicën e popullsisë dhe më specifikisht duke rritur dinamikat e punësimit informal, të përkohshëm dhe të pasigurtë të

popullsisë rome dhe egjiptiane, duke degraduar gjithmonë e më shumë drejt punëve më të ulta të cilat jo në pak raste nuk sigurojnë dot as të ardhura minimale për mbijetesë⁴⁷.

3.5 Arsimi e formimi profesional

Edhe pse arsimi profesional⁴⁸ është një ndër hallkat e rëndësishme që ofron mundësi për integrimin në tregun e punës, të dhënat zyrtare tregojnë se në Bashkinë Durrës vetëm 11 persona (4 romë dhe 7 egjiptianë) janë të regjistruar në Qëndrat e Formimit Profesional nga ky komunitet për 2016, një numër tejet i papërfillshëm nëse konsiderojmë nevojat që ka ky komunitet për arsim profesional. Ndërsa kurset më të preferuara nga komunitetet Rome dhe Egjiptiane për 2016 kanë qënë kurset për berber, instalime elektrike, dhe parukeri, vetëm 1 person rezulton të jetë femër⁴⁹. Të dhënat zyrtare⁵⁰, konfirmojnë se në krahasim me vitet e mëparshme, aktualisht ka një interes më të lartë nga ky komunitet për të ndjekur kurset profesionale të tilla si hoteleri turizëm, kamarier, banakier, punonjës çadrash dhe rrobaqepësi, reflektuar kjo në një rritje të regjistrimit me 35% më shumë për vitin 2017.

E megjithatë, anketa e zhvilluar me anëtarë të të dy komuniteteve (IDM, 2017) konfirmon se vetëm 7.4% e të anketuarve romë dhe egjiptianë kanë ndjekur kurse të formimit profesional, kundrejt 90.5% që janë përgjigjur negativisht dhe 2.1% të cilët i janë përgjigjur 'nuk e di'. Të pyetur nëse anëtarët e tjerë të komunitetit kanë ndjekur kurse profesionale, rreth 12% përgjigjen 'po', 12.6% përgjigjen 'jo' dhe 74.7% nuk janë në dijeni⁵¹. Një prej arsyeve rreth shkallës së lartë në mosfrekuentimin e kurseve dhe mungesës së njohurive, mund të jetë e lidhur me largësinë dhe pamundësinë e

47. Gëdeshi & Miluka, 2012

48. Në Durrës ushtrojnë veprimtarinë dy shkolla Profesionale, Shkolla Profesionale Beqir Cela dhe Shkolla Teknologjike Hysen Çela, marrë nga http://www.vet.al/shkollat_arsimit_profesional/publike, aksesuar më 25 Gusht 2017.

49. Të dhëna të ofruara nga Qëndrat e Formimit Profesional Publik në Bashkinë Durrës

50. Po aty

51. IDM, 2007

transportit për të ndjekur formimin profesional shtetëror i cili mbulohet nga Qëndrat e Formimit Profesional të vendosura në qytetin e Durrësit. Njëkohësisht, faktorë të tjerë të tillë si migrimi i shpeshtë, mentaliteti dhe mënyra jetesës, formimi i hershëm i familjeve mund të shërbejnë si barriera të tjera.

Për më tepër, 57.9% e të anketuarëve shprehen se nuk e dine nëse këto kurse lehtësojnë punësimin, ku 2.1 % janë shprehur negativisht. Sfidat e integritit të romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës janë të shumta sikurse u përmendën më sipër, dhe formimi i tyre profesional përbën një prej hallkave më të rëndësishme të integritit të qëndrueshëm të këtij komuniteti në tregun e punës. Problematik është fakti se një pjesë e konsiderueshme e këtij komuniteti nuk janë aspak në dijeni për përfitimet që mund të sjelli arsimi profesional në rritjen e mundësive për punësim.

3.6 Programet e zhvillimit profesional & riintegritit në tregun e punës për komunitetin Rom dhe Egjiptian

Ekzistojnë disa programe punësimi të cilat kanë për qëllim nxitjen e punësimin të grupeve vulnerabël dhe janë të dobishme dhe të shfrytëzueshme edhe nga komuniteti Rom dhe Egjiptian, të cilët kategorizohen si grupe të veçanta për të përfituar nga këto programe⁵². Megjithatë nuk ka të dhëna për numrin e përfituesëve romë dhe egjiptianë nga këto komunitete. Duke filluar nga viti 2016, Në bashkinë Durrës, 7 romë dhe egjiptianë kanë përfituar nga programi i intershipeve në kuadër të projektit ESERE⁵³. Në Durrës programet e zhvillimit profesional apo riintegritit në tregun e punës për komunitetin Rom dhe Egjiptian ofrohen gjithashtu nga organizata të shoqërisë civile që operojnë në Durrës (sipas

52. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 65, datë 27.1.2016, Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 47, datë 16.1.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për programin e nxitjes së punësimin, nëpërmjet formimit në punë", të ndryshuar

53. Programi i intershipeve në kuadër të projektit "Fuqizimi ekonomik dhe social i komunitetit Rom dhe Egjiptian" 2016-2017, i shtrirë në 4 qytete me përqendrim të madh të komunitetit Rom dhe Egjiptian: Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Berat, zbatohet nga UNDP Albania në bashkëpunim me Roma Versitas Albania. <http://romaversitasalbania.org/intership-scheme/> aksesuar më 22 Gusht 2017

tabelës Nr. 4). Për të inkurajuar anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian të zhvillojnë bizneset e tyre, janë ofruar edhe grante të ndryshme nga Terres des Homes, Durrës por edhe nga UNDP, përmes projektit ESERE. Sipas të dhënave nga Qendra Multifunksionale Nishtulla, janë ofruar grante deri në 100 000 lekë nga programi i gjenerimit të të ardhurave, për 5 familje nga komuniteti Rom i zonës së Nishtullës. Këto grante rezultuan të suksesshme për 2 familje që vazhdojnë akoma biznesin e tyre (shitje e rrobave të përdorura) si dhe për 3 familje të tjera pati sukses vetëm 6 muajt e parë që nga marrja e grantit⁵⁴.

Edhe pse këto programe 'ad hoc' dhe mund të kenë pasur një efekt pozitiv në rikualifikimin e të rinjve apo në nxitjen e iniciativave të vetë-punësimit, brenda një periudhe të caktuar kohore, mungesa e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së tyre, fragmentizimi dhe moskoordinimi i shërbimeve nuk krijon baza të qëndrueshme për rifitimin e njohurive profesionale të nevojshme për punësim për zbutjen e varfërisë.

4. Kujdesi shëndetësor

Situata shëndetësore e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri priret të jetë përgjithësisht më e përkeqësuar krahasuar me popullsinë në shumicë⁵⁵. Romët kanë një jetëgjatësi mesatare të paktën 10 vite më të ulët se popullsia shumicë dhe kanë një shkallë të lartë të vdekshmërisë foshnjore⁵⁶. Në përgjithësi romët karakterizohen nga një incidencë më e lartë sëmundshmërie dhe janë më të prekshëm sidomos ndaj sëmundjeve të transmetueshme, sëmundjeve kardiovaskulare, të shoqëruara nga ato reumatizmale, të diabetit, neurologjike dhe psikiatrike, të veshkave,

54. Qendra Komunitare Multifunksionale Nishtulla

55. Gedeshi, I. & Miluka, J. (2012). Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri. Center for Economic dhe Social Studies (CESS), UNDP: Tiranë.

56. Komisioni Evropian, Raport mbi shëndetin e komunitetit rom: Gjendja shëndetësore e popullsisë rome dhe monitorimi i të dhënave të mbledhura në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, prill 2014, http://ec.europa.eu/health/social_determinants/docs/2014_roma_health_report_en.pdf, f. 37.

të stomakut dhe ato të organeve të frymëmarrjes⁵⁷. Edhe pse aksesit në shërbimin shëndetësor parësor ofrohet falas në të gjitha qendrat shëndetësore⁵⁸, ky komunitet ka një akses shumë të ulët në shërbimin e kujdesit parësor dhe atë të specialiteteve, shpesh herë kjo edhe për shkak të stilit të tyre të jetesës jo të shëndetshme dhe kushteve sociale ekonomike të cilat favorizojnë sëmundjet kronike. Ka një sërë faktorësh qëndikojnë në degradimin e gjëndjes së tyre shëndetësore, duke përfshirë këtu kushtet e papërshtatshme të jetesës, dieta e varfër ushqimore, mungesa e aksesit ndaj shërbimeve shëndetësore, mungesa e informacionit kundrejt shërbimeve shëndetësore dhe mbi të gjitha varfëria ekstreme dhe niveli i lartë i ekspozimit ndaj kushteve ekstremisht të pasigurta të banesave të tyre.

Në fushën e shëndetësisë përgjegjësia e njësive të qeverisjes vendore shtrihet vetëm në mirëmbajtjen e infrastrukturës së shërbimit të kujdesit parësor. Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës është institucioni kryesor i cili mbulon këtë fushë⁵⁹. Momentalisht shërbimi shëndetësor pranë mjekut të familjes ofrohet falas si për personat e pa siguruar dhe atësiguruar.

Aktualisht, numri i romëve të pajisur me kartela shëndetësore në Bashkinë Durrës është 1205 persona, prej të cilëve 450 edhe me karta shëndeti. Popullsia egjiptiane pajisur me kartela shëndetësore arrin në 1404 persona, prej të cilëve 574 me kartë shëndeti⁶⁰. Për shkak se në Nishtullë është krijuar një qëndër shëndetësore (QSH. Nr.7) e cila u ofron shërbim parësor banorëve të zonës, është ngritur si problem mos tërheqja e kartelave shëndetësore nga banorët e zonës (transferimi nga Qendra Shëndetësore Shkozë tek mjeku aktual i familjes në Qendrën Shëndetësore Nishtullë), megjithëse është ofruar informacion mbi rregullat e transferimit të

57. Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë Shqiptare 2016-2020 http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/draft_strategjia/Draft_Strategjia_30Maj2016_ëeb.pdf , aksesuar me 18.07.2017; Gëdeshi & Miluka, 2012

58. Urdhëri nr 28, datë 26.01.2016 Për sistemin e referimit dhe tarifave të shërbimit shëndetësor publik

59. Burimi i të dhënave: Plani Lokal i Përfshirjes Sociale Durrës, 2017-2019.

60. Burimi: Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës, 2017

kartelave shëndetësore. Edhe pse stafet shëndetësore vazhdojnë të punojnë intensivisht mbi informimin e popullatës për çdo ndryshim në aksesin shëndetësor, ka në përgjithësi një ndërgjegjësim të ulët nga komuniteti për shkak të faktorëve të sipërpërmendur. Në shërbimin parësor nuk ka asnjë të punësuar nga romët dhe egjiptianët. Për sa i përket mbulimit me qendra shëndetësore, në vendbanimet romë dhe egjiptiane nuk ka problem me largësinë nga këto qendra pasi popullata është e mbuluar. Gjithashtu ekipi mjekësor nuk ka hasur rezistencë nga familjarët për vaksinimin e fëmijëve. Infrastruktura e qendrës shëndetësore Kulla ka nevojë për rikonstrukcion dhe Xhafzotaj për një hapësirë më të madhe.

Tabela.1 Shtrirja e Qendrave Shëndetësore i Qendrave Shëndetësore në Bashkinë Durrës

Njesia Administrative	Qendra shëndetësore
Nr.4	1 qender shëndetësore (QSh nr 4)
Nr.5	2 qendra shëndetësore(Qsh 7 dhe Qendra shëndetësore Nishtulla);
Nr.3	1 qendër shëndetësore QSH nr 3
Sukth	7 Qendra shëndetësore
Rrashbull	7 qendra shëndetësore dhe 3 ambulanca

Burimi: Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës, 2017

4.1 Planifikimi familjar

Lidhur me planifikimin familjar në njësitë administrative të Sukthit dhe Rrashbullit ka konsultor të gruas(pranë qendrës shëndetësore) dhe rrjedhimisht pika të planifikimit familjar. Në Q.SH Nr. 4 dhe Q.sh. Nr. 7(ku përfshihet dhe Q.SH Nishtulla) planifikimi familjar është në nivel informimi pranë mjekut të familjes, ndërsa shërbimi ofrohet falas në Qendrën e Shëndetit të Gruas dhe Pikën e Planifikimit Familjar pranë Maternitetit në Spitalin Rajonal Durrës⁶¹. Edhe pse, aktualisht infermierët e patronazhit e kanë pjesë të punës se tyre daljen në terren për evidentimin e çdo gruaje

61. Burimi: Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës, 2017

shtatzëne dhe kontrollin e çdo fëmije 0-6 vjeç, si dhe është prioritarë krijimi i ekipeve mjekësore lëvizëse shtesë në terren⁶². Në përgjithësi, gratë e komunitetit Rom dhe Egjiptian karakterizohen nga lindshmëri të hershme, shkallë të lartë fertiliteti dhe mungesë të thellë njohurie mbi metodat e planifikimit familjar.

Sipas një studimi njohuritë dhe aftësitë e nënave rome për të ndihmuar në zhvillimin e gjuhës dhe zhvillimit mendor të fëmijës janë shumë të pakta dhe thuajse inekzistente sa i përket ushqimit të fëmijëve sipas një diete të balancuar. Si rrjedhojë, studimi nxori përfundimin se 38% e fëmijëve të vlerësuar, kanë rezultuar të kenë vonesa të dukshme zhvillimi në më shumë se dy fusha, kjo edhe për shkak të kushteve të këqija socio-ekonomike të cilat krijojnë barriera në stimulimin pozitiv prind-fëmijë.

4.2 Pajisja me karta shëndeti

Nga intervistat në terren me anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian (IDM, 2017) rezulton se një pëqindje e lartë e tyre, rreth 53.7% nuk kanë kartë shëndeti, kundrejt 42.1% që e kanë kartën e shëndetit. Përmes intervistave të zhvilluara, prindërit romë dhe egjiptianë shprehen se përballen me vështirësi në sigurimin e kartës së shëndetit duke renditur disa shkaqe që lidhen kryesisht me mungesën e njohurive për procedurat përkatëse (32 persona), neglizhencën, mungesa financiare për të akeluar qëndrat shëndetësore nëpërmjet transportit, mungesa e pashaportizimit. E megjithatë, personeli mjekësor shprehet se ky komunitet nuk penalizohet në aksesin ndaj shërbimeve mjekësore edhe në rastet kur u mungon karta e shëndetit.

Të pyetur se si e vlerësojnë në përgjithësi gjendjen shëndetësore të komunitetit afër zonave ku banojnë, 41% e të anketuarve janë shprehur keq, 41% mesatarisht, 10.5% mirë, 2.1% shumë mire dhe 3.1% shumë keq.

62. Ky prioritet pritet të jetë pjesë e një projekti, granti të vogël të dhënë nga UNDP ndaj organizates Romano Kham

Si do ta vlerësonit në përgjithësi gjendjen shëndetësore në komunitetin tuaj?




Figura. 6. Vlerësim mbi gjendjen e përgjithshme shëndetësore
Burimi: Anketa e IDM (2017)

Një pikë e dobët qëndrave shëndetësore ka të bëjë me faktin se personeli mjekësor nuk ka ndonjë regjistër të posaçëm të sëmundjeve kronike, epidemiologjisë apo prognozave të sëmundjeve specifiktë për këtë komunitet⁶³. Në lidhje me vlerësimin e cilësinë e shërbimeve shëndetësore që ofrohen në zonën e komunitetit, të anketuarit përgjigjen se shërbimi ofrohet njëllor për të gjithë, por anëtarët neglizhojnë të kërkojnë shërbim shpesh here edhe si pasojë e mungesës së kartave shëndetësore, mundësive të ulëta financiare, korrupsionit, ofrimit të shërbimeve mjekësore tejet minimale për të adresuar nevojat e tyre mjekësore, apo cilësisë së shërbimeve.

4.3 Aksesit në shërbimet shëndetësore

Të pyetur më specifiktë se si vetë anëtarët e komunitetit e vlerësojnë mundësinë që ka komuniteti i tyre për t'i përdorur shërbimet shëndetësore, rezultojnë se rreth 42.1% i janë përgjigjur 'keq', 38.9% 'mesatarisht', 13.7% 'mirë', 3.1% 'shumë mire' dhe 2.1% 'shumë keq'. Problem kryesor tjetër i evidentuar nga rezultatet me karta shëndeti dhe për më tepër që shpesh herë nuk ju ofrohen mjafuëshëm udhëzime apo ndihmë lehtësuese sipas kërkesave dhe nevojave të komunitetit.

63. Qendra e Shëndetit dhe Mirëqenies Komunitare (2011). Vizitat në shtëpi për promovimin e zhvillimit të shëndetshëm të fëmijëve Rom në Tiranë dhe Durrës, Maj 2011. UNICEF

Strehimi social në Bashkinë Durrës ofrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike

Bashkia Durrës ofron aktualisht disa programe të strehimit social në të cilët mund të aplikojnë familjet ose individët, si për shembull:

1. Për banesa sociale me qera sipas projektit nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEB) për ndërtimin e banesave të reja, i cili është në zbatim prej vitit 2014;

Numri i familjeve romë që kanë përfituar raportohet të jetë zero dhe numri i familjeve egjiptiane është 27, kundrejt 39 familjeve që kanë aplikuar nga ky komunitet.

2. Për kredi të lehtësuar për strehim me 3 % interes të financuara nga buxheti i shtetit përmes Ministrisë së Zhvillimit Urban;

Jane 103 familje që kane banuar ne shtepite e ish-pronareve dhe kane perfituar kredine me interes 0%. Janë 180 familje që kanë statusin të pastrehë dhe kane perfituar kredine me interes 3%. Këto janë para vitit 2016. Nuk ka përfitues nga komunitetet Rome dhe Egjiptiane.

3. Për banesa me kosto të ulët, që ndërtohen nga Enti Kombëtar i Banesave dhe financohet nga buxheti i shtetit përmes Ministrisë së Zhvillimit Urban;

4. Për bonus strehimi që përfitojnë të gjithë ato familje që kanë në përbërjen e tyre familjare nga një anëtar invalid, jetim, rom, egjiptian etj. Bonusi i strehimit i referohet vetëm banesave sociale me qera dhe konsiston në likuidimin e 50 % të vlerës së qerasë së banesës të kësaj kategorie e cila financohet nga buxheti i shtetit përmes Ministrisë së Zhvillimit Urban;

5. Për grantin e menjëhershëm për strehim të gjithë ato familje që kanë në përbërjen e tyre familjare nga një anëtar invalid, jetim, rom, egjiptian etj. Granti i menjëhershëm për strehim konsiston në likuidimin e 10 % -20 % të vlerës së banesës me kosto të ulët të kësaj kategorie e cila financohet nga buxheti i shtetit.

Si e vlerësoni mundësinë që ka komuniteti juaj për të përdorur shërbimet shëndetësore?




Figura. 7. Aksesi në Shërbimet Shëndetësore
Burimi: Anketa e IDM (2017)

E megjithatë largësia nga qendra shëndetësore dhe pamundësia e transportit për të aksesuar shërbimet e specialiteteve përbën pengesën kryesore për rreth 46% të të pyeturve.

Kjo për arsye se vetëm KSHP, ofrojnë shërbimet shëndetësore lehtësisht të aksesueshme pranë vendbanimeve të tyre vlerësohet se aksesi i romëve dhe egjiptianëve në institucionet shëndetësore në Durrës nuk është pranueshëm.

Edhe pse shërbimi shëndetësor ofrohet i pa diskriminuar për çdo anëtar të komunitetit përfshirë edhe atë të komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Sikurse evidentohet më sipër, adresimi i nevojave të komunitetit mund të realizohet vetëm nëse bashkëpunohet në mënyrë proaktive me të gjitha institucionet e tjera të përfshira, pasi prishja e një hallke të zinxhirit, pengon vijueshmërinë e punës në një hallkë tjetër.

4.4 Vlerësimi i stafit shëndetësor

Si do ta vlerësonit sjelljen e stafit shëndetësor në qendrën shëndetësore të lagjes suaj ndaj komunitetit Rom/Egjiptian?




Figura. 8. Vlerësimi mbi Shërbimet Shëndetësore
Burimi: Anketa e IDM (2017)

Në lidhje me vlerësimin e sjelljes së stafit shëndetësor në qendrën shëndetësore të lagjes ndaj komunitetit Rom dhe Egjiptian, rreth 1/3 të anketuarve janë përgjigjur se në përgjithësi trajtohen njëjloj si gjithë të tjerët me respekt dhe pa diskriminim (33%), edhe pse nuk mungojnë sjelljet diskriminuese, indiferentizmi, mospërfillja për shkak të racës. Të anketuarit njëkohësisht shprehen për gatishmërinë e stafit për të ndihmuar edhe në rastet kur vetë ata janë paraqitur pa karta shëndetësore.

Në përgjithësi pothuajse gjysma e të anektuarve shprehen me nota pozitive rreth stafit shëndetësor duke e vlerësuar sjelljen e tyre si të mirë 52.6%, dhe mesatare 23.1%.

Barrierat për marrjen e kujdesit shëndetësor

Një sërë barrierash mund të penalizojnë këtë komunitet në marrjen e

shërbimit mjekësor në kohë dhe në vazhdimësi, si mungesa e njohurive, largësia e vendbanimit nga poliklinika eshërbimevetëspecializuara. Për më tepër duke marrë parasysh informalitetin e lartë të punëve që karakterizon këtë komunitet, mungesën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore apo të ardhurat financiare tepër minimale, krijohenbarriera në marrjen e shërbimit mjekësor.

5. Strehimi dhe integrimi urban

Një ndër problemet më të mëdha me të cilën përballen anëtarët komunitetit Rom dhe Egjiptian ka të bëjë me vendbanimet e papërshtatshme dhe të pasigurta ku jetojnë këto familje si edhe aksesit shumë i ulët në programet sociale të strehimit. Mospasja e një strehimi të sigurt kushtëzon ndjeshëm cilësinë e jetës në të gjitha fushat e tjera. Në zonat ku ka një shumicë të komunitetit Rom dhe Egjiptian ka probleme shqetësuese jo vetëm me informalitetin e banesave por gjithashtu në lidhje me infrastrukturën rrugore, ndriçimin, furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizimin e ujrave të zeza, probleme të cilat ndikojnë ndjeshëm në cilësinë e jetesës së këtyre familjeve.

Edhe pse këto programe synojnë të adresojnë grupet e pafavorizuara, të cilat kanë të ardhura të ulëta⁶⁴, romët dhe egjiptianët përfitojnë në një masë shumë të ulët nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit⁶⁵. Në Durrës situata e strehimit shfaqet kritike, pasi rreth 350 familje (77%) nga komuniteti Rom dhe 115 familje (62%) nga komuniteti Egjiptian, kanë nevoja për strehim për shkak se jetojnë në banesa jashtë kushteve standarte⁶⁶. Në një total të 279 intervista të kryera me familjet rome në qarkun e Durrësit, rezulton se gjatë periudhës 2005-2014, vetëm 6.4% e familjeve të këtij komuniteti kanë përfituar nga programet sociale të strehimit (Strategjia e Strehimit Social 2016-2025).

Për sa i përket programeve sociale të strehimit, situata paraqitet lehtësisht favorizuese për komunitetin Egjiptian, ku numri i përfituesëve të banesave

64. Neni 3 i ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale të strehimit"

65. Vendim i KM nr 405, datë 1.6.2016 Për Miratimin e Strategjisë së Strehimit Social 2016-2025

66. Referuar studimit të kryer nga Qendra Kombëtare për Studime Sociale & W&P Infrastruture Consultants (2016)

sociale me qera për vitin 2016 shkon në 27 përfitues nga 39 që kanë shprehur kërkesën për të përfitur nga ky program. Sipas të dhënave zyrtare në Bashkinë e Durrësit, egjiptianët përfitojnë nga strehimi social në masën 5-7% të totalit të përfituesëve (totali 254 familje nga të cilat 126 familje përfituese miratuar me VKB NR.248 datë 10.05.2017 dhe 128 familje përfituese me VKB Nr.315 datë 18.12.2015, këto familje përfituese kanë lidhur kontratat respektive me Bashkinë Durrës në vitet 2015 dhe 2016). Referuar po të njëjtit burim zyrtar, panorama paraqitet tejet e zymtë për komunitetin Rom, duke marrë parasysh se asnjë anëtar i komunitetit nuk ka përfitur nga programet sociale të strehimit, konkretisht nga banesat sociale me qera. Romët dhe egjiptianët kanë avantazh në sistemin e pikëzimit elektronik të strehimit, ku përfitojnë automatikisht 5 pikë më shumë për shkak të etnisë.

E megjithatë, i njëjti sistem i përjashton ata për shkak të mospajisjes me dokumentacionin e nevojshëm. Duke marrë parasysh nivelin e ulët të arsimimit të anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian, njohuritë e ulëta për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm, u heqin të drejtën përfituesëve të mundshëm për t'u trajtuar me banesë sociale me qera apo kosto të ulët, edhe pse favorizohen nga sistemi.

Më poshtë paraqitet situatën e lidhje me strehimin dhe integrimin urban:

5.1 Vendbanimet: Nga të dhënat e mbledhura nga Censusi për Banesat dhe Popullatën rome në Shqipëri (2014), në Durrës⁶⁷ rezulton se:

- Nga 279 familje të intervistuar numri i familjeve rome të cilat jetojnë në shtëpi private (me tulla, bloqe apo beton) është 47%, ndërkohë 5% jetojnë në apartament në pallat; 6% jetojnë në banesë e përshtatur në një objekt të përbashkët dhe 9% jetojnë në banesa të llojit kasolle (e rrethuar me dërrasa, llamarinë apo plasmas). Rezulton se zona e Nishtullës ka një numër të madh, rreth 104 familje rome të cilat jetojnë në banesa të pabanueshme apo pothuajse

67. Katund i Ri; Rashbull; Sukth; Durrës

të pabanueshme⁶⁸. Pikërisht kushtet e pashëndetshme dhe të papërshtatshme të banesave të tyre të improvizuara me plastikë apo materiale të tjera përbëjnë shkakun kryesor të shpeshitë të sëmundjeve të frymëmarrjes.

- Sipas burimeve zyrtare të të dhënave, në Bashkinë e Durrësit rezultojnë 350 familje rome dhe 115 egjiptiane të pastreha, të cilat kanë aplikuar pranë Bashkisë Durrës për përfitimin e banesave sociale⁶⁹.
- Një pjesë e konsiderueshme e banesave Rome dhe Egjiptiane në zonën Nishtulla, Kullë, Çezma e Ferrës dhe Rrashbull kanë nevojë të menjëhershme për rikonstrukcion, për shkak të gjendjes së tyre shumë të të papërshtatshme.
- Gjithashtu, disa institucione arsimore në zonat ku ka përqëndrim të komunitetit Rom dhe Egjiptian kanë nevojë për ndërhyrje emergjente. Koncretisht, në zonën Çezma e Ferrës, Kopshti “Foto Monobeu”, Shkolla “Eftali Koci”; në Nishtullë Kopshti dhe Shkolla “Isuf Ferra”; në Durrës Shkolla “Qemal Mici” dhe Shkolla “14 Nentori”; në Sukth, Kopshti “Kullë”.
- Vendbanimet e pozicionuara në afërsi të lumit dhe për pasojë të rrezikuara nga përmbytjet.
- Akoma më problematike shfaqet situata e kushteve higjieno-sanitare, ku rreth 96 % e familjeve rome dhe egjiptiane në Durrës nuk përmbushin standardet e kërkuara sipas studimit nga Qendra Kombëtare për Studime Sociale & W&P Infrastructure Consultants (2016).

68. OSFA, 2014

69. Të dhëna të ofruara nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës, 2017



Foto të banesave të familjeve në zonën e Nishtullës dhe Çezma e Ferrës:

5.2 Legalizimi:

Sipas studimit të SOROS (2014), rezulton se në Bashkinë Durrës (Sukth, Rrazhbull, Katund i Ri, Durrës) 33 banesa të familjeve romë janë pa dokumenta, ndërkohë 72 banesa të tjera janë në proces legalizimi.

5.3 Furnizimi me ujë të pijshëm:

Sipas të dhënave nga Bashkia Durrës, zonat mbuloohen 100% nga shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm në gjëndje të pastër, por problemi kryesor qëndron orari i furnizimit me ujë të pijshëm, ku specifikisht në(Nj.A) Nr.4, furnizimi me ujë të pastër është 1 orë, (Nj.A) Nr.5 furnizimi është 20 orë, Nj.A Sukth furnizimi është 1 orë, Nj.A Kulla furnizimi është 4 orë, dhe (Nj.A.)Nr.3 furnizimi është 4 orë.

5.4 Kanalizimi i ujërave të zeza

është një ndër problemet që shqetëson kryesisht Nj.A.Sukth dhe Kulla, (Nj.A). Rrashbull (Xhafzotaj), pasi në këto zona nuk ka shërbim për ujërat e zeza. Problemi i kanalizimeve - në Nishtullë është një problem tepër i rrezikshëm për familjet që jetojnë në këto zona. Ndërkohë, gjëndja e agravuar rreth kanalizimeve bëhet shkak për epidemi dhe sëmundje infektive që mund të përhapen në një frekuencë më të lartë tek kjo popullatë.

5.5 Infrastruktura rrugore

Sipas të dhënave nga Bashkia Durrës,2017 ekzistojnë probleme me infrastrukturën rrugore kryesisht në Nishtullë, Shkozet Durrës ku kryesisht mungon asfaltimi dhe ndriçimi në territorin në të cilin ata banojnë. Gjithashtu theksojmë se mungon plotësisht gjelbërimi në këtë zonë. ekzistojnë probleme me infrastrukturën rrugore pasi vetëm (Nj.A) Nr.4 ka 1km asfalt dhe (Nj.A) Nr.5 ka 0.9 km asfalt⁷⁰.

70. Të dhëna të ofruara nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës, 2017



Foto ilustruese që tregojnë Infrastrukturën në zonën e Nishtullës dhe Çezma Ferrës

5.6 Furnizimi me energji elektrike

Sipas studimit të SOROS (2014), rezulton se në Nj.Ad. Sukth 6% të familjeve rome nuk mbulohen nga rrjeti i energjisë elektrike; në Nj.Ad. Durrës 23 % të familjeve rome nuk mbulohen nga rrjeti i energjisë elektrike; në Nj.Ad. Rrashbull 9 % të familjeve rome nuk mbulohen nga rrjeti i energjisë elektrike. Sipas të dhënave zyrtare, aktualisht në zonën e Nishtullës këto familje furnizohen nga rrjeti i energjisë elektrike në mënyrë abuzive⁷¹.

5.7 Vlerësimi i kushteve të banimit

Sipas studimit të kryer nga IDM (2017), në lidhje me banesën rezulton se 29.4% e të anketuarëve i vlerësojnë kushtet e banimit 'shumë keq' dhe 'mesatare' ndërkohë q; 70.5% janë shprehur 'mirë' dhe 'shumë mirë'.

71. Po aty

Si janë kushtet higjeno-sanitare në shtëpinë tuaj?




Figura. 9. Vlerësimi i kushteve higjeno-sanitare (IDM, 2017)

Fakti që pjesa më e madhe e të intervistuarëve janë shprehur me nota pozitive, përpos situatës alarmante të strehimit dhe kushteve higjeno-sanitare tejet të agravuara tregon që edhe insistimi i këtij komuniteti për të kërkuar kushte më të mira vendbanimi do të jetë në koherencë me këtë qëndrim pozitiv. Pikërisht, ky ndërgjegjësim i ulët rreth kushteve reale përbën një problem akoma më madhor pasi kemi të bëjmë me një mosnjohje të situatës reale.

Legalizimi : Sipas studimit nga IDM (2017), një tjetër shqetësim për anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian është legalizimi i banesave ku ata jetojnë. Pjesa më e madhe e të anketuarëve 69.1% kanë pronësinë e banesës ku jetojnë, ndërkohë 7.4% janë me qera, 13.8% janë të pastrehë dhe 7.4% e të pyeturve pohojnë se banesat e tyre janë në proces legalizimi.

Hapësirat e banimit:

Përpos vështirësive që romët dhe egjiptianët hasin në lidhje me banesat e tyre, pjesa më e madhe, rreth 52.6% pohojnë se jetojnë me 5-8 anëtarë në familje; 10.5% jetojnë me më shumë se 8 anëtarë dhe rreth 36.8% jetojnë me 1-4 anëtarë. Bashkëjetesa në një familje të madhe edhe pse mund të ketë anë pozitive, në rastin kur nuk ka hapësirë të mjaftueshme në banesë

përbën një problem. Sa i përket kushteve higjeno-sanitare të banesave, 19.1% përgjigjen 'shumë keq'; 10.6% përgjigjen 'keq'; 8.5% përgjigjen 'mesatare'; 61.4% e të anketuarëve përgjigjen 'mirë' dhe 'shumë mirë'.

Programet e strehimit & barrierat:

Të pyetur nëse vetë anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian kanë përfituar ndonjëherë nga programet sociale të strehimit (banesa sociale me qera/banesa me kosto të ulët, vetëm 1.1% e të intervistuarëve kanë përfituar nga kjo skemë, kundrejt 40.6 % që nuk kanë aplikuar dhe 47.2% që nuk janë në dijeni të kësaj skeme (IDM, 2017). Nuk mungojnë rastet që nuk e njohin aspak këtë program. Një pjesë tjetër shprehet se nuk ka mundur të aplikojë për shkak të korrupsionit ose të ardhurave të pamjaftueshme, pasi për të përfituar nga banesat sociale me qera të ulët, vetë personi duhet të konfirmojë qëndrueshmërinë e të ardhurave nëpërmjet kontratës së punës. Disa nga barrierat e tjera që pengon këtë komunitet të përfitojë nga shërbimet sociale kanë të bëjnë me mospërbushjen e kushteve ligjore. Ndër faktorët e tjerë të përmendur gjatë intervistave në terren janë: përjashtimi i këtij komuniteti nga tregu formal i punës, mosregjistrimi civil, mosdeklarimi i etnisë, vendbanimet në qytete të tjera, mungesa e kapaciteteve të vete institucioneve dhe mungesa e informacionit⁷².

Familjet rome, janë relativisht të mëdha në numër dhe mosndarja nga trangu familjar përbën një problem për të mos përfituar nga banesat sociale, pasi standardet e vendosura nuk lejojnë më shumë se 12 m² për frymë. Në bashkinë e Durrësit familjet rome dhe egjiptiane mund të përfitojnë nga sistemi i bonusit të strehimit, i cili parashikon mbulimin e qerasë në masën 50%. Gjithësesi, duke marrë parasysh që shumë kontrata të qerave nuk janë të noterizuara këto familje nuk i përmbushin kriteret për të përfituar nga kjo skemë. Në pamje të parë situata e skemave sociale

72. IDM 2017

në Bashkinë Durrës duket premtuese për familjet vulnerabël. Për fat të keq edhe pse destinacioni i këtyre skemave është krijuar për familjet e varfëra, ligji përjashton familjet tepër të varfëra, të cilat nuk sigurojnë dot as të ardhurat minimale të jetesës, duke riprodhuar kështu një cikël të ri të varfërisë. Institucioni i Bashkisë Durrës⁷³ ka në pronësi truall të lirë për ndërtim, si në zonat ku jeton ky komunitet dhe në një zonë tjetër por është e nevojshme financimi nga ana e donatorëve për ndërtim. Situata paraqitet në nota të njëjta për sa i përket përfitimit të ndihmave nga shteti si i pastrehë (pagesë të qerasë/ pagesë të interesave të kredive / grant për banesë me kosto të ulët /etj, ku vetëm 1.1% kanë përfituar nga këto programe, kundrejt 50.8 % që shprehen se nuk kanë aplikuar. Shumica e të anketuarëve janë pesimistë rreth idese se ata mund të përfitojnë nga këto skema, ku pengesë mund të behet diskriminimi për shkak të ngjyrës. E megjithatë situata nuk është favorizuese dhe për 18.4% e të anketuarve të cilët dhe pse kanë aplikuar dhe janë në pritje prej një periudhe shumë të gjatë kohe nuk kanë përfituar. Ndërkohë, 20.6% nuk janë në dijeni të programeve të tilla.

Perceptimi mbi infrastrukturën e zonës:

Përpos kapaciteteve të dobëta të institucioneve për të mbështetur me skema financiare komunitetin Rom dhe Egjiptian, një tjetër problem madhor vazhdon të ngelet infrastruktura e dobët për sa i përket rrugëve, ujësjellsave, kanalizimeve në zonat ku ata banojnë. Problematika më e madhe që rezulton sipas anketës ka të bëjë me kanalizimet e ujërave të zeza të cilat bllokohen në rast të kushteve atmosferike jo të favorshme. Në rastet e reshjeve të mëdha të shiut lagjet e këtyre komuniteteve përmythen, duke e bërë pothuajse të pamundur lëvizshmërinë e qytetarëve dhe shpesh duke vënë në rrezik edhe jetën e tyre. Kjo panoramë shfaqet edhe më e zymtë nëse do t'i referoheshim rezultateve të studimit të cilat dëshmojnë se pjesa dërrmuese e të anketuarëve

